



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”**  
**(TEMATIK)**

**BASHKIA KORÇË**

**SHTATOR, 2019**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

**PËRMBAJTJA:**

<b>NR</b>	<b>EMËRTIMI I KAPITUJVE</b>	<b>FAQE</b>
<b>I</b>	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3- 8
<b>II</b>	HYRJA	9-10
<b>III</b>	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	10-10
<b>IV</b>	GJETJET DHE REKOMANDIMET	11- 45
<b>V</b>	ANEKSE	46-52



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.**

#### **SHKURTIME:**

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
TAK	Titullari i Autoritetit Kontraktor
AK	Autoriteti Kontraktor



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Korçë në bazë të Autorizimit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 495/2 datë 31.07.2019, me afat auditimi deri në datën 06.09.2019, për auditimin tematik mbi “Investimin e kryer për ndërtimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar” nga Bashkia Korçë.

#### I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në PRA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar” sipërmarrësi BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, ka përfitur më tepër duke vendosur pajisje jo sipas specifikimeve teknike dhe jo funksionale në objekt në vlerën <b>1,462,000 lekë pa TVSH.</b>	<b>Pika 5.2 Faqe 32-37</b>	<b>E lartë</b>	Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>1,462,000 lekë pa TVSH</b> nga BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të pajisjeve të pa vendosura në objekt sipas preventivit të miratuar nga AK.
	Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar” sipërmarrësi BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, ka përfitur më tepër për punime të pakryera vlerën <b>366,667 lekë pa TVSH.</b>	<b>Pika 5.2 Faqe 32-37</b>	<b>E lartë</b>	Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>366,667 lekë pa TVSH</b> nga BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo në përputhje faktin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK.
3	Nga auditimi ka rezultuar se personat përgjegjës për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i shfuqizuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” dhe Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3	<b>Pika 2.3 Faqe 11-32</b>	<b>E lartë</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e Bashkisë Korçë, i cili në rastin konkret (Vlera limit e kontratës me objekt “Ndërtim i Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

	<p>“Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë” dhe VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i shfuqizuar, me pasojë përlllogaritje më tepër e vlerës limit të kontratës <b>në shumën 3,499,806 lekë pa TVSH.</b></p> <p>Referuar të dhënave në disa raste nuk janë vendosur në Preventiv çmimet për njësi të përlllogaritura sipas analizës teknike dhe të kostos, si dhe manualeve të çmimeve konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për zërin e punimeve “Veshje fasade me pllaka guri”, çmimi në preventiv është përlllogaritur <b>2,032,500 lekë më shumë.</b></li> <li>-Për zërin e punimeve “Veshje xokoli me pllaka guri”, çmimi në preventiv është përlllogaritur <b>703,953 lekë më shumë.</b></li> <li>-Për zërin e punimeve “Veshje tarrace me pllaka guri”, çmimi në preventiv është përlllogaritur <b>673,353 lekë më shumë.</b></li> </ul> <p>Për zërin “Punime të ndryshme”, nënzërin “Urë metalike+druri të lëvizshme” çmimi në preventiv është <b>90,000 lekë më shumë.</b></p>			Mesjetar”) është përlllogaritur <b>3,499,806 lekë më shumë.</b>
4	<p>Nga auditimi ka rezultuar se nga grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç. <b>Në 18 raste</b>, çmimet për njësi të zërave të punimeve në preventiv, nuk i janë referuar as çmimeve sipas Manualeve teknike të çmimeve për punimet në ndërtim dhe analizave teknike të tyre, të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, si dhe as analizës teknike dhe të kostos të kryer nga vetë grupi i punës.</p>	<b>Pika 2.3 Faqe 11-32</b>	<b>E lartë</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, ku mungojnë analizat, argumentimi si dhe referencat për çmimet e preventivuara, me pasojë rritjen e riskut për shkaktimin e efekteve financiare negative, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.
5	<p>Nga auditimi ka rezultuar se në procedurën me objekt “Ndërtim i objektit Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës” nga ana e KVO-së është vepruar në kundërshtim me LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, pasi OE të shpalluar fitues nuk i kanë plotësuar kriteret për kualifikim, duke shkaktuar dhe <b>përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 41,096,244 lekë pa TVSH.</b></p>	<b>Pika 2.4 Faqe 11-32</b>	<b>E mesme</b>	Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë, të cilët edhe pse nuk kanë plotësuar kriteret e për kualifikim të përcaktuara në DT, janë shpallur fitues, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, të cilat cenojnë sigurinë për realizimin me cilësi të kontratave.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

6	<p>-Nga NJP, në hartimin e kriterëve për kualifikim, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” nuk është marrë në konsideratë, dokumentacioni i cilësuar në specifikimet teknike, me qëllim përmbushjen e tyre. Konkretisht për materialet e “Veshje fasade” dhe “Profile alumini”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kapitulli III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.</p> <p>-Nga NJP, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i infrastrukturës së brendshme të objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 26 “Kontratat për punë”, pasi nuk është përcaktuar në DT, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesin OE, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim në rastin e automjeteve (leje qarkullimi, akt kolaudimi, certifikata transporti etj), dokumentacioni i cili vërteton gjendjen fizike të mjeteve dhe garancinë për realizimin e kontratës.</p>	<b>Pika 2.2</b> <b>Faqe</b> <b>11-32</b>	<b>E mesme</b>	Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për përcaktimin e kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur, që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim.
---	---	--	----------------	---

#### I.c. Opinioni i auditimit.

##### **Për drejtimin e Bashkisë Korçë:**

Ne kemi audituar përputhshmërinë<sup>1</sup> prokurimit të fondeve publike për ndërtimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në fushën e prokurimeve publike.

Auditimi ka përfshirë auditimin e 2 procedurave të prokurimit të zhvilluar në vitin 2014 dhe 2015.

##### **Opinion i modifikuar "Me rezervë":**

Sipas mendimit tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, ne gjetëm që, përveç çështjeve të përshkruara në “Bazën për opinionin me rezervë”, informacioni mbi objektin dhe çështjen e audituar të subjektit është në përputhje, në çdo aspekt material, me kriteret e vlerësimit, dhe që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura<sup>2</sup>.

##### **Baza për opinionin e modifikuar me "Rezervë":**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në

<sup>1</sup> ISSAI 4100 Audituesit e Sektorit Publik i planifikojnë dhe i kryejnë auditimet për të përcaktuar nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale, është në përputhje me kriteret e përcaktuara.

<sup>2</sup> Vetë auditimi është tematik, i fokusuar në procedurat e prokurimit për ndërtimin e objektit “Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar” Korçë, i cili përfshin vetëm dy procedura.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>3</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se subjekti i audituar nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për disa çështjeve të cilat janë materiale, por jo të përhapura), për të cilat sqarojmë:

#### ***Mbi zbatimin e kontratës:***

Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës, sipërmarrësi BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, ka përfituar më tepër vlerën **1,828,667 lekë pa TVSH**. Konkretisht, për mos vendosje të pajisjeve në objekt vlerën 1,462,000 lekë dhe për punime të pakryera vlerën 366,667 lekë.

#### ***Nga përlllogaritja e vlerës limit të kontratës:***

**a.** Nga auditimi ka rezultuar se nga grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk ka vepruar në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç. Vlera e saj është përlllogaritur **3,499,806 lekë më shumë**, pasi për disa zëra punimesh çmimet e preventivuara nuk kanë qenë në përputhje me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, si dhe “Analizën teknike dhe të kostos së punimeve” të hartuar nga vetë grupi i punës.

**b.** Nga auditimi ka rezultuar se nga grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç. **Në 18 raste**, çmimet për njësi të zërave të punimeve në preventiv, nuk i janë referuar as çmimeve sipas Manualeve teknike të çmimeve për punimet në ndërtim dhe analizave teknike të tyre, të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, si dhe as analizës teknike dhe të kostos të kryer nga vetë grupi i punës.

#### ***Mbi përcaktimin e kritereve për kualifikim:***

-Nga NJP, në hartimin e kritereve për kualifikim, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” nuk është marrë në konsideratë, dokumentacioni i cilësuar në specifikimet teknike, me qëllim përmbushjen e tyre. Konkretisht për materialet e “Veshje fasade” dhe “Profile alumini”.

-Nga NJP, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i infrastrukturës së brendshme të objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 26 “Kontratat për punë”, pasi nuk është përcaktuar në DT, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesin OE, për përmbushjen e kritereve për kualifikim në rastin e automjeteve (leje qarkullimi, akt kolaudimi, certifikata transporti etj), dokumentacioni i cili vërteton gjendjen fizike të mjeteve dhe garancinë për realizimin e kontratës.

#### ***Mbi zhvillimin e procedurave, vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit:***

Nga auditimi ka rezultuar se në procedurën e zhvilluar me objekt “Ndërtim i objektit Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës”, nga ana e KVO-së është vepruar në kundërshtim me LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, pasi

<sup>3</sup>Objektivi i audituesve është të hartojnë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojnë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

OE të shpalluar fitues nuk i kanë plotësuar kriteret për kualifikim, duke shkaktuar dhe përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **41,096,244 lekë pa TVSH.**

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Korçë:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të cilat duhet të mbështeten nga një sistem i kontrollit të brendshëm funksional. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të prokurimeve publike dhe përdorimin e burimeve financiare të vëna në dispozicion në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomalitë materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI (100<sup>4</sup>, 400<sup>5</sup>, 4100<sup>6</sup>), audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me ligjet dhe rregullat.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.”

<sup>5</sup> (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

<sup>6</sup> ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare”;

<sup>7</sup> ISSAI 4100 Audituesit e Sektorit Publik i planifikojnë dhe i kryejnë auditimet për të përcaktuar nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale, është në përputhje me kriteret e përcaktuara.





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Autorizimit të Auditimit nr.495/2 datë 31.07.2019 “Auditim tematik/përputhshmërie në Bashkinë Korçë”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 19.08.2019-06.09.2019, në subjektin Bashkia Korçë u krye auditimi “Auditim tematik përputhshmërie” nga **Grupi i Auditimit me përbërje:**

1. B.Z., Përgjegjëse Grupi
2. M.H., Auditues
3. A.Z., Auditues
4. I.D., Ekspert i jashtëm

**Titulli:** Auditim përputhshmërie (tematik) në Bashkinë Korçë.

**Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Korçë.

**Procedura e ndjekur:** Raporti Përfundimtar i Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Korçë, pasi nga subjekti me shkresat përcjellëse janë paraqitur kundërshtitë rreth Projeportit të Auditimit, përcjellë në subjekt me shkresën nr. 495/3, datë 17.09.2019, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili së bashku me rekomandimet i përcillet subjektit për zbatim.

**Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit mbi përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve publike, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kriteret e paracaktuara).

### **Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:**

- Procedurat e financimit për investimet e kryera në objektin “Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë”
- Procedurat e prokurimit dhe lidhja e kontratave;
- Zbatimi i Kontratave dhe likuidimi i tyre.

### **Kriteret e vlerësimit:**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, referenca të tjera ligjore si dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik);
- ISSAI 400- (Parimet themelore të auditimit përputhshmërisë);
- Manualin e Auditimit Përputhshmërisë;
- Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime;



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.**

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime;
- Ligjin nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë”, i shfuqizuar;
- VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” me ndryshime (aktualisht i shfuqizuar);
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime;
- VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i shfuqizuar;
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, etj.

#### **Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet, dhe teknika auditimi, duke përfshirë intervista dhe testim për procedurat të cilat ishin në fokus të këtij auditimi tematik, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në kryerjen e këtij investimi, në përputhje me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **Informacioni i Përgjithshëm:**

Ky auditim është zhvilluar bazuar në Autorizimin e auditimit nr. 495/2, datë 31.07.2019, për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga z. K.B., ish punonjës i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë, administruar në KLSH me nr. 495, datë 02.07.2019.

Grupi i auditimit u fokusua në problematikat e ngritura në këtë ankesë, për të gjitha ato çështje që disponon aftësitë dhe kompetencat profesionale.

Konkretisht, auditimi u fokusua në burimet dhe financimin e dy investimeve të kryera për ndërtimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, zhvillimin e procedurave, zbatimin dhe likuidimin e kontratës.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.**

**Mbi procedurën me objekt “Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”/“Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” në Korçë.**

**Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:**

- Burimet e financimit;
- Angazhimi i fondeve për kryerjen e këtij investimi;
- Procedurat e prokurimit mbi ndërtimin e objektit “Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”;

*Në lidhje me procedurën e prokurimit u audituan:*

- Përcaktimi i specifikimeve teknike;
- Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit;
- Përlllogaritja e fondit limit;
- Hartimi dhe miratimi i DT;
- Vlerësimi i ofertave;
- Shpallja e fituesit dhe lidhja e kontratës;
- Përmbajtja e dosjes së prokurimit;
- Likuidimi i kontratës;

**Dokumentacioni i shqyrtuar:**

- Shkresat mbi alokimin e fondeve;
- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE nga OE;
- Dokumentacioni bankar mbi likuidimin e situacioneve;

**Nga auditimi ka rezultuar:**

#### **1. Burimet e financimit dhe anagazhimi i fondeve për hapjen e procedurës:**

- Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë, është krijuar në vitin 1980. Nga auditimi ka rezultuar se investimi i kryer për ndërtimin e Muzeut (të ri) Kombëtar të Artit Mesjetar, u konceptua të ishte pjesë e investimit me objekt “Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës”, ku ishte parashikuar të ndërtoheshin edhe ambiente të tjera (ansambël kulturor).
- Për mungesë financimi nuk u realizua gjithë projekt-idea dhe objekti i cili u ndërtua funksionon si Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar. Objekti është pronë e Bashkisë Korçë, pasi është financuar nga Bashkia Korçë, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, ndërsa administrimi dhe organizimi i tij është kryer në përputhje me ligjin nr. 9386<sup>8</sup>, datë 04.05.2005 “Për muzetë”, Kreu II “Llojet e muzeve” neni 5 “Muzetë kombëtare”, pika 1, 3 dhe 4 ku cilësohet:

*1. Muzetë kombëtare janë persona juridike publike, ne varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ata shpallen ose krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e*

<sup>8</sup> Aktualisht i shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

*Ministrit te Kulturës, Rinise dhe Sporteve, pasi te jete marre me pare mendimi i Komisionit Shtetëror te Muzeve.*

*3. Ministri i Kulturës, Rinise dhe Sporteve miraton statutin e funksionimit te muzeve kombëtare. Kalimi i një muzeu vendor ne kombëtar, si dhe ndryshimi i përgjegjësisë se administrimit te mjediseve te muzeut behet me vendim te Këshillit te Ministrave, ne përputhje me ligjin nr.8743, date 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme te shtetit", si dhe me këtë ligj.*

*4. Drejtuesit e muzeve kombëtare emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Ministri i Kulturës, Rinise dhe Sporteve.*

Në Kreun III "Funksionimi i muzeve" neni 10 "Drejtimi metodik dhe administrativ i muzeve publike" pika 2, cilësohet:

*Nga pikëpamja e kompetencës administrative, muzetë drejtohen nga organi nga i cili varen apo nga institucioni ne juridiksionin e te cilit ndodhet muzeu.*

Kjo procedurë është tender i "Hapur", me vlerë limit të kontratës në shumën 49,968,529 lekë pa TVSH dhe në shumën 59,957,487 lekë me TVSH, burimi i financimit nga buxheti i shtetit, nëpërmjet projekteve të artit dhe kulturës të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 118, datë 31.07.2014.

#### **Financimi sipas burimit:**

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 60,000,000 lekë

#### **Financimi sipas periudhave:**

- Në vitin 2014 38,819,000 lekë;
- Në vitin 2015 21,181,000 lekë;
- **Totali: 60,000,000 lekë**
- **Fondi limit 59,957,487 lekë**

**Konkluzion:** Sa më sipër, nga AK Bashkia Korçë është vepruar në përputhje me LPP, me ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", me ndryshime Kapitulli III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike", "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike", pika nr. 140, ku cilësohet:

*Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.*

## 2. Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit:

### Procedura me objekt "Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës"

Të dhëna mbi procedurën		
Urdhër Prokurimi nr. 42, datë 11.08.2014	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 42, datë 11.08.2014	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 42/1, datë 11.08.2014
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Matilda Stena</li> <li>2. Miladin Fili</li> <li>3. Bujar Meta</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Benila Themeli, Kryetare</li> <li>2. Mirjana Lika, Anëtare</li> <li>3. Anxhela Dishnica, Anëtare</li> <li>4. Leonard Gjançi, Anëtar</li> <li>5. Nikolin Saraçi, Anëtar</li> </ol>



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Fondi limit pa tvsh: 49,968,529 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 41,096,244 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 8,872,285 lekë
Data e hapjes së procedurës: 04.09.2014 ora 11.00	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit. Fondi i zhvillimit të rajoneve.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 10 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 2 (dy) OE c. S'kualifikuar: 5 (pesë) OE d. Nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike: 3 (tre) OE
Ankimime: Nuk ka	Përgjigje ankesës nga AK.: -	Përgjigje ankesës nga: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

#### **2.1.Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë përcaktuar nga znj. E. Th. dhe znj. V. P. Në bazë të projektit teknik janë përcaktuar dhe hartuar Specifikimet teknike. Në dosjen e tenderit ndodhet Leje zhvillimore ndërtimi, Mendimi i Këshillit teknik, Akt-pëlqimi mjedisor dhe Raporti i ndikimit në mjedis, Plani i përgjithshëm, Plani i vendosjes së strukturës, Specifikimet teknike , Grafiku i punimeve dhe Preventivi.

Sipas zërave të punimeve janë përcaktuar specifikimet teknike, për muraturat, punime betoni armimi dhe hekuri, punimet elektrike, mekanike si dhe specifikime të përgjithshme ku janë përfshirë dorëzimet te supervizori.

- Për betonet është përcaktuar lloji i materialeve, depozitimi i materialeve, prodhimi i betonit, hedhja e betonit, realizimi i bashkimeve, mbrojtja, etj.
- Për punimet elektrike janë përcaktuar lloji i kablllove sipas standardeve, specifikat (përmasat), ngjyrat, skica të ndryshme, etj.
- Për panelet elektrike është përcaktuar funksionimi, të dhënat teknike, skica etj.
- Për punimet mekanike janë përshkruar të dhënat e materialeve (përbërja, përmasat, etj).

**Konkluzion:** Sa më sipër, nga personat përgjegjës është vepruar në përputhje me LPP, neni 23 “Specifikimet teknike” pika 3 dhe 4.

#### **2.2.Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Nga ana e NJP, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim, të cilat janë trajtuar në Procesverbalin nr. 1, datë 11.08.2014 “Mbi hartimin dhe miratimin e DT.

- Përcaktimi i “Kriterëve të përgjithshme për kualifikim” është bërë në përputhje me VKM dhe DST “Për punët publike”.
- Përcaktimi i “Kriterëve të veçanta për kualifikim” u konstatuan këto mangësi:

#### **Gjetje nga auditimi: Përcaktimi i “Kriterëve të veçanta për kualifikim”**

##### **Situata 1:**

Nga NJP, nuk është kërkuar në DT, dokumentacioni mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas cilësimeve të bëra, për materialet e mëposhtme:

**Veshje fasade:** Në specifikimet teknike është kërkuar që materialet e gurëve **duhet të jenë të shoqëruara** me testin për ujëthithjen, porozitetin dhe koeficientin e ngopjes sipas standardit BS EN 1936:2006 dhe testin e rezistencës ndaj ngrirjes sipas klasifikimit BRE, klasa A.

**Profilet e aluminit:** Në specifikimet teknike është kërkuar që profilet e aluminit **duhet të jenë të shoqëruara** me certifikata IQNET. ELOT.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

- CERF.QUALICOAT.CE dhe sistemi të jetë i certifikuar nga një institut evropian.
- Kriteri 1:** VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kapitulli III “Dokumentet e tenderti”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”, ku cilësohet: *“Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve, që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera, që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46, të LPP-së. Këto duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.*
- Shkaku:** Mosveprim nga ana e NJP.
- Ndikimi:** Mund të ndikojë në realizimin e kontratës.
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandim 1:** Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për përcaktimin kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur, që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** NJP, e cila ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, ku cilësohet:

*“Njësia është plotësisht përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit, kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit, ...”*

#### **2.3.Mbi përlogaritjen e vlerës limit të kontratës.**

Nga z. B. M. (inxhinier ndërtimi) dhe znj. V. P. (inxhinierë elektrike) është hartuar preventivi me vlerë totale 59,957,487 lekë me TVSH dhe 49,968,529 lekë pa TVSH.

#### **Gjetje nga auditimi: Mbi dokumentimin e procedurës së prokurimit.**

- Situata:** Për përcaktimin e çmimeve për njësi dhe hartimin e preventivit, nga personat përgjegjës nuk është mbajtur Procesverbal, me qëllim dhënien e shpjegimeve dhe argumenteve mbi aplikimin e çmimeve përkatëse apo analizës së kostos së kryer për zërat e punimeve.
- Kriteri:** Ky veprim është në kundërshtim me LPP neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” pika 2, ku cilësohet: *Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.*
- Shkaku:** Mosveprim nga ana e personave përgjegjës për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe NJP.
- Ndikimi:** Nuk ka gjurmë auditimi mbi veprimet e kryera dhe qëndrimet e personave përkatës.
- Rëndësia:** E mesme



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Për të vlerësuar përlllogaritjen e fondit limit, Grupi i auditimit, me zgjedhje për disa nga zërat e punimeve, krahasoi çmimet sipas preventivit me çmimet e disa zërave sipas Manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013<sup>9</sup>, si dhe analizave teknike dhe kostos së tyre të përlllogaritura nga AK, sipas *Pasqyrës anakse nr.1 "Zërat e punimeve sipas Preventiv-Manualeve-Analizave teknike dhe kostos së tyre nga AK"*

#### **Gjetje nga auditimi: Mbi përcaktimin e çmimeve për njësi dhe argumentimin e tyre.**

- Situata:** Referuar të dhënave të Pasqyrës anakse nr. 2, ka rezultuar se nga personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit", pika 2 "Llogaritja e vlerës së kontratës", germa ç, pasi **për 18 raste** "zëra punimesh" nuk ka gjurmë, mbi mënyrën e përlllogaritjes së çmimeve të preventivuara. Personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në përcaktimin e çmimeve për njësi sipas zërave të punimeve, nuk i janë referuar as çmimeve sipas "Manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre" të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, si dhe as kanë kryer analizë çmimesh. Në dokumentin "Analiza teknike për punimet në ndërtim" të hartuar nga vetë grupi i punës, rezulton se nuk janë trajtuar këta zëra. Për shkak se mungon procesverbali mbi "Përlllogaritjen e fondit limit" nuk kemi asnjë gjurmë se si është vepruar.
- Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit", pika 2 "Llogaritja e vlerës së kontratës", germa ç, *ku cilësohet: "Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse dhe, në çdo rast, i dokumenton ato"*.
- Shkaku:** Mosveprim i personave përgjegjës për përlllogaritjen e FL.
- Ndikimi:** Ndikon në vlerën limit të kontratës.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, ku mungojnë analizat, argumentimi si dhe referencat për çmimet e preventivuara, me pasojë rritjen e riskun për shkaktimin e efekteve financiare negative, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

#### **Gjetje nga auditimi: Mbi përcaktimin e çmimeve për njësi dhe argumentimin e tyre.**

Nga krahasimi i çmimeve të preventivuara me çmimet për njësi të përlllogaritura sipas analizës teknike dhe të kostos, si dhe manualeve ka rezultuar se nga personat përgjegjës, në disa raste nuk janë vendosur në

<sup>9</sup> Aktualisht i shfuqizuar.



## KONTROLI I LARTË I SHITETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

- Situata 1:** preventiv të çmimet sipas analizës apo manualeve, **duke shkaktuar rritje të vlerës limit të kontratës në shumën 3,499,806 lekë**, konkretisht:
- Për zërin “Punime të ndryshme”, nën zërin “Urë metalike+druri të lëvizshme” sipas Analizës është përlogaritur çmimi për nën zërin “Mekanizmi lëvizës” sipas Analizës është përlogaritur në shumën 190,000 lekë/copa, ndërsa në Preventiv është shënuar 280,000 lekë/copa. Diferenca për këtë zë punimesh midis Analizës dhe Preventivit është **90,000 lekë**.
- Situata 2:**
- Për zërin e punimeve “Veshje fasade me pllaka guri” në analizën e kostos është përlogaritur çmimi në vlerën 5,500 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas dokumentit “Analiza teknike për punimet e ndërtimit” për këtë objekt çmimi i përlogaritur është 5,500 lekë/m<sup>2</sup>, për shkak se trashësia e gurit që do të përdoret do të jetë t=10cm, e përcaktuar kjo në DT “Specifikimet teknike”. Si rezultat i kësaj vlera limit e kontratës është përlogaritur më shumë në vlerën **2,032,500 lekë** ( $8,000 \text{ lekë/m}^2 - 5,500 \text{ lekë/m}^2 = 2,500 \text{ lekë/m}^2 * 813 \text{ m}^2 = 2,032,500 \text{ lekë}$ ).
- Situata 3:**
- Për zërin e punimeve “Veshje xokoli me pllaka guri”, me çmim 8,000 lekë/njësi, sipas preventivit, nuk është përcaktuar trashësia e gurit (t), as në DT “Specifikimet teknike” dhe as në Preventiv. Gjithashtu, nga personat përgjegjës për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, në dokumentin “Analiza teknike për punimet e ndërtimit me objekt “Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës””, nuk ka analizë kostoje për këtë zë punimesh. Në preventiv çmimi për këtë zë punimesh është përcaktuar 8,000 lekë/m<sup>2</sup>, duke ju referuar çmimit/njësi të zërit të punimeve “Veshje fasade me pllaka guri”, për të cilin në Specifikimet teknike të DT, është ciësuar trashësia e gurit t=10 cm.
- Sa më sipër, rezulton se çmimi 8,000 lekë/njësi i vendosur në preventiv, është i paargumentuar si dhe duke ju referuar Manualit nr. 2 të miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kosto për njësi e këtij zëri punimeve “Veshje me pllaka guri” duhej përlogaritur në vlerën 3,399 lekë/m<sup>2</sup>. Për rrjedhojë vlera e fondit limit për këtë zë është përlogaritur **703,953 lekë më shumë** ( $8,000 \text{ lekë/m}^2 - 3,399 \text{ lekë/m}^2 = 4,601 \text{ lekë/m}^2 * 153 \text{ m}^2 = 703,953 \text{ lekë}$ ).
- Situata 4:**
- Për zërin e punimeve “Veshje tarrace me pllaka guri”, me çmim 7,800 lekë/njësi, sipas preventivit, nuk është përcaktuar trashësia e gurit (t), as në Specifikimet teknike (Dokumentet e Tenderit) dhe as në Preventiv. Gjithashtu, nga personat përgjegjës për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, në dokumentin “Analiza teknike për punimet e ndërtimit me objekt “Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës””, nuk ka analizë kostoje për këtë zë punimesh. Në preventiv çmimi për këtë zë punimesh është përcaktuar 7,800 lekë/m<sup>2</sup>.
- Sa më sipër, rezulton se çmimi 7,800 lekë/njësi i vendosur në preventiv, është i paargumentuar si dhe duke ju referuar Manualit nr. 2 të miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kosto për njësi e këtij





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

zëri punimeve “Veshje me pllaka guri” duhej përlogaritur në vlerën 3,399 lekë/m<sup>2</sup>. Për rrjedhojë vlera e fondit limit për këtë zë është përlogaritur **673,353 lekë më shumë** ( $7,800 \text{ lekë/m}^2 - 3,399 \text{ lekë/m}^2 = 4,401 \text{ lekë/m}^2 * 153 \text{ m}^2 = 673,353 \text{ lekë}$ ).

- Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me ndryshime:  
Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç, ku cilësohet: “*Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse dhe, në çdo rast, i dokumenton ato*”.  
Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” dhe Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”, ku cilësohet: “*...Çmimet e vlerësuar duhet t’u referohen statistikave ose manualeve të fushës së ndërtimit, nëse ka të tilla...*”.
- Shkaku:** Mosveprim i personave përgjegjës për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, në përputhje me rregullat e prokurimit publik.
- Ndikimi:** Ndikon në vlerën limit të kontratës, konkretisht vlera limit e kontratës është përlogaritur 3,499,806 lekë më shumë.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve me efekte financiare negative në buxhetin e Bashkisë Korçë, e cila në rastin konkret është **vlerën 3,499,806 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Personat përgjegjës z. B. M. për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës.

#### **2.4.Hartimi dhe miratimi i Dokumenteve të Tenderit (DT)**

Nga Njësia e Prokurimit (NJP), janë hartuar dhe miratuar DT me Procesverbalin nr. 1, datë 11.08.2014. Procesverbali është firmosur nga të gjithë anëtarët e NJP. Gjithashtu, nga NJP është hartuar seti i plotë i DT, të cilat janë firmosur në çdo faqe nga NJP. Pjesë e DT, janë të gjithë shtojcat e përcaktuara në DST.

**Konkluzion:** Sa më sipër, NJP ka vepruar në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007<sup>10</sup> me ndryshime, Kreu III “Dokumentet e Tenderit”, pika 1 “Dokumentet standarde të tenderit”; pika 2 “Informacion i përgjithshëm”; pika 3 “Informacione të veçanta” germa a “Kontratat për punë” dhe pika 4 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”.

#### **2.5.Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 10 OE, nga të cilët 3 nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike, janë kualifikuar 2 dhe janë skualifikuar 5 OE.

<sup>10</sup> Aktualisht i shfuqizuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "Favin" SHPK & "Albavia" SHPK	31,847,836
2	OE "K" SHPK	34,190,835
3	<b>BOE "M" SHPK "EK" SHPK</b>	<b>41,085,744</b>
4	OE "Bajrami N" SHPK	42,393,165
5	BOE "XH" SHPK & "Curri" SHPK	43,713,821
6	OE "Be-Is" SHPK	44,739,797
7	OE "Kacdedja" SHPK	44,959,488
8	OE "Shpresa" SHPK	-
9	OE "Aurora Konstruksion" SHPK	-
10	OE "Eurotek Alb" SHPK	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Punoi: KLSH

Nga KVO sipas Procesverbalit nr. 2, datë 17.09.2014, është kryer shqyrtimi i ofertave dhe ka rezultuar si më poshtë:

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	BOE "Favin" SHPK & "Albavia" SHPK	31,847,836
2	OE "K" SHPK	34,190,835
3	OE "Bajrami N" SHPK	42,393,165
4	OE "Be-Is" SHPK	44,739,797
5	OE "Kacdedja" SHPK	44,959,488

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Punoi: KLSH

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët se BOE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

BOE "Favina" SHPK & "Albavia" SHPK, me ofertë në shumën 31,847,836 lekë dhe OE "K" SHPK, me ofertë në shumën 34,190,835 lekë, nuk kanë plotësuar disa kriteret kualifikuese (trajtuar hollësisht në aktkonstatimi nr. 1, datë 06.09.2019):

**Konkluzion:**Skualifikimi i BOE "Favina" SHPK & "Albavia" SHPK dhe OE "K" SHPK, nga KVO është bërë në përputhje me:

LPP, neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve" pika 1, ku cilësohet:

*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

LPP, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, ku cilësohet:

*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
3	<b>BOE "M" SHPK "EK" SHPK</b>	<b>41,085,744</b>
5	BOE "XH" SHPK & "Curri" SHPK	43,713,821

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Punoi: KLSH

Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, të BOE të shpallur fitues "M" SHPK & "EK" SHPK, ka rezultuar se:



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

BOE “M” SHPK & “EK” SHPK, ka lidhur Aktmarrëveshjen nr.4106 rep., datë 03.09.2014 “Për bashkimin e OE në këtë procedurë prokurimi”, si dhe ka nënshkruar Aktin noterial për përfaqësimin e BOE, nga OE “M” SHPK.

Nga ana e OE është përcaktuar pjesëmarrja për realizimin e kësaj kontrate. në raportin 70 % OE “M” SHPK dhe 30 % OE “EK” SHPK. Në Aktmarrëveshje, është cilësuar se: “Raportet e mësipërme të pjesëmarrjes në bashkimin e OE në zëra punimesh referuar preventivit të këtij objekti do jenë **70 % “M” SHPK për çdo zë punimesh dhe 30 % “EK” SHPK për çdo zë punimesh**”. Kontrata e bashkëpunimit është në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Nga auditimi i ofertave në SPE rezultuan këto mangësi:

**Gjetje nga auditimi:** Mbi vlerësimin e OE, të shpallur fitues.

#### **Situata 1:**

OE “M” SHPK, nuk ka plotësuar kriterin mbi kapacitetin ekonomiko-financiar, pasi xhiro mesatare e tre viteve të fundit është më e vogël nga sa është kërkuar në DT, pika 2.1. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, ku cilësohet: ***Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3(tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë sa vlera e fondit limit. Kjo do të vertetohet duke paraqitur vertetim per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit leshuar nga administrata tatimore.***

Konkretisht:

Vlera limit e kontratës=49,968 mijë lekë, sipas së cilës xhiro mesatare e 3 viteve dhe përqindjes së pjesëmarrjes duhet të plotësohet si më poshtë:

OE “M” SHPK, në shumën 34,978 mijë lekë

OE “EK” në shumën 14,990 mijë lekë

OE “M” SHPK, sipas vërtetimit nga administrata tatimore, ka realizuar xhiro vjetore si më poshtë:

Viti 2011 31,745 mijë lekë

Viti 2012 25,360 mijë lekë

Viti 2013 18,604 mijë lekë

Totali 75,709 mijë lekë

Xhiro mesatare e tre viteve  $75,709/3=25,236$  mijë lekë, vlerë e cila duhet të ishte në shumën 34,745 mijë lekë.

#### **Situata 2:**

- OE “EK” SHPK, nuk ka paraqitur Certifikatat ISO 18001:2007 dhe ISO 99:2012.

#### **Kriteri 1 dhe 2:**

- Veprim në kundërshtim me VKM, Kreu VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2 “Bashkimi i OE”, germa c, ku cilësohet: ***Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”***

- Aktmarrëveshjen nr. 4106 Rep., datë 03.09.2014, Paragrafi “Pjesëmarrja e anëtarëve të BOE” ku cilësohet: *Pjesëmarrja e antërave të BOE do të jetë:*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

“M” SHPK 70% të punimeve dhe “EK” SHPK 30% të punimeve. Ky raport do të zbatohet në këtë përqindje për çdo zë të punimeve”.

- DT, “Kapaciteti teknik” pika 5, ku cilësohet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si me poshte:

-Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur ISO 9001:2008

-Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur ISO 14001:2004

-Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur ISO 18001:2007

-Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur (PAS99:2012)

**Shkaku:** Mosveprim i anëtarëve të KVO-së, në perputhje me kriteret e vlerësimit.

**Ndikimi:** Ndikim në vlerësimin e OE dhe realizimin e kontratës, por që në rastin konkret nuk ka patur ndikim, pasi kontrata është realizuar.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomik, të cilët edhe pse nuk kanë plotësuar kriteret e DST janë kualifikuar dhe ahpallur fitues, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratave.

**Konkluzion:** KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, ku cilësohet:

*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

LPP, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 ku cilësohet:

*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, bazuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, germa ç “Komisioni i vlerësimit të ofertave” ku cilësohet:

*“KVO, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor, përbëhet nga jo më pak se 3 persona, specialistë të fushës, dhe është përgjegjës vetëm për shqyrtimin e ofertave...”*

#### **2.6.Mbi shpalljen e fituesit dhe lidhjen e Kontratës**

Nga AK është shpallur fitues BOE “M” SHPK & “EK” SHPK. Nga KVO është hartuar dhe miratuar nga TAK Raporti përmbledhës. Nga AK është plotësuar Formulari i Njoftimit të fituesit datë 02.10.2014, i cili është botuar në Buletinin e APP-së nr. 06.10.2014. Midis AK dhe BOE është nënshkruar Kontrata datë 16.10.2014, si dhe është dorëzuar Formulari i Sigurimit të Kontratës datë 07.10.2014 nga BOE. Nga AK është plotësuar “Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar” si dhe Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës, publikuar në Buletinin e APP-së datë 27.10.2014.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

**Konkluzion:** Në lidhjen e Kontratës dhe publikimin e saj nga AK janë zbatuar afatet e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

#### **3. Përmbajtja/dokumentacioni i dosjes së prokurimit:**

Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e prokurimit, u konstatuan këto mangësi:

**Gjetje nga auditimi:** Mbi dokumentacionin e dosjes së prokurimit:

**Situata:** -Nuk ka Urdhër të TAK për përcaktimin e personave përgjegjës, për përcaktimin e specifikimeve teknike. Nga NJP nuk është parë e nevojshme ngritja e urdhrave të titullarit për shkak se personat të cilët kanë kryer këto detyra janë punonjës të Drejtorisë së politikave të zhvillimit, planifikimit strategjik dhe koordinimit me donatorët, e cila sipas rregullores ka për detyrë: *Siguron asistencë për hartimin e projekteve të paraqitura nga të gjitha drejtoritë e Bashkisë së Korçës dhe përgatit projekte konkrete bazuara në prioritete për t'ju paraqitur kryesisht se Bashkisë për aprovim.*

-Urdhri i TAK për përcaktimin e personave përgjegjës, për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (Fondi limit).

**Kriteri:** TAK, i cili ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, germa a dhe b, pasi nuk ka ngritur grupet e punës si dhe personat të cilat kanë përllogaritur vlerën limit të kontratës.

**Gjithashtu, për mungesën e dokumentacionit të mësipërm në dosjen e prokurimit mban përgjegjësi dhe NJP,** e cila ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 1 “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, germa b ku cilësohet: *“Çdo autoritet kontraktor ngre një njësi prokurimi, e cila duhet të administrojë, në mënyrë të vazhdueshme, procesin e prokurimit...”*

**Shkaku:** Mosveprim i NJP.

**Ndikimi:** Nuk ka patur ndikim.

**Rëndësia:** E ulët

**Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për nxjerrjen e urdharve, për ngarkimin e personave përgjegjës, për përcaktimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në rast se këto detyra nuk mund të kryhen nga NJP, për shkak të mungesës së ekspezizës.

#### **4. Mbi likuidimin e situacioneve pjesore dhe përfundimtar:**

Kontrata e sipërmarrjes me objekt “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës” është lidhur midis BOE dhe Bashkisë Korçë, datë 16.10.2014.

Kontrata me objekt “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës” me vlerë 49,302,893 lekë me TVSH, ka afat maksimal të përfundimit të punimeve 6 muaj. Bazuar në Aktin e kolaudimit datë 05.10.2015 të nënshkruar nga:

Kolaudator objekti: “Novatech Studio” SHPK

Mbikëqyrësi i punimeve: “Infra Konsult” SHPK

Sipërmarrës: BOE “M” SHPK & “EK” SHPK, realizimi i kontratës është realizuar:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

- Data e fillimit të punimeve: 17.10.2014
- Data e përfundimit të punimeve: 05.09.2015

Afati i kryerjes së punimeve sipas kontratës ka qenë 6 muaj dhe është përfunduar për 9 muaj. Moskryerja në afat e punimeve për shkak të kushteve atmosferike është dokumentuar me kërkesën e BOE datë 10.12.2014 dhe miratimin e Kryetarit të Bashkisë Korçë (pa afat).

Gjithashtu po me vendim të Kryetarit të Bashkisë Korçë në cilësinë e Titullarit të AK, janë pezulluar punimet edhe më datë 17.07.2015 (pa afat).

Likuidimi është bërë sipas situacioneve priodike dhe atij përfundimtar për sa më poshtë:

#### Likuidimi i kontratës

Nr.	Urdhër shpenzimi		Situacioni		Vlera	Garanci punimesh 5%	Likuiduar
	Numër	Data	Numër	Datë			
1	723	11.12.2014	1	17.11.2014	6,865,560	343,278	6,522,282
2	768	17.12.2014	2	10.12.2014	16,133,928	806,696	15,327,232
3	797	26.12.2014	3	22.12.2014	819,000	40,950	778,050
4	372	17.06.2015	4	30.05.2015	10,466,400	523,320	9,943,080
5	885	20.11.2015	5	02.07.2015	10,993,861	549,693	10,444,168
6	1060	16.12.2015	P/6	20.11.2015	4,023,936	201,197	3,822,739
7	<b>Totali</b>				<b>49,302,685</b>	<b>2,465,134</b>	<b>46,837,551</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

Garancia e punimeve në vlerën 2,465,134 lekë, i është likuiduar BOE sipas Urdhër shpenzimit nr. 1003, datë 07.11.2017, bazuar në Urdhrin e TAK nr. 715, datë 27.10.2017, Certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve, datë 13.10.2017, Situacionin përfundimtar datë 20.11.2015 dhe Procesverbalin e kolaudimit datë 05.10.2015, të nënshkruar nga Mbikëqyrësi i punimeve, Sipërmarrësi i punimeve dhe Kolaudatori, pas përfundimit të afatit 2 vjeçar të garancisë.

**Konkluzion:** Drejtoria e Financës, ka vepruar në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe VKB nr. 5, datë 12.01.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017”.

#### **Mbi procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i infrastrukturës së brendshme të objektit Qendra për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar” në Korçë.**

##### **Për auditimin e kësaj nënçështjeje u verifikuan:**

- Burimet e financimit;
- Angazhimi i fondeve për kryerjen e këtij investimi;
- Procedurat e prokurimit mbi ndërtimin e infrastrukturës së brendshme të objektit “Qendra për ruajtjen dhe promovimin e kulturës”;

##### *Në lidhje me procedurën e prokurimit u audituan:*

- Përcaktimi i specifikimeve teknike;
- Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit;
- Përlllogaritja e fondit limit;
- Hartimi dhe miratimi i DT;
- Vlerësimi i ofertave;
- Shpallja e fituesit dhe lidhja e kontratës;



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

- Përmbajtja e dosjes së prokurimit;
- Likuidimi i kontratës;

#### Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Shkresat mbi alokimin e fondeve;
- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE nga OE;
- Dokumentacioni bankar mbi likuidimin e situacioneve;

#### Nga auditimi ka rezultuar:

##### **1. Burimet e financimit dhe anagazhimi i fondeve për hapjen e procedurës:**

Kjo procedurë është tender i “Hapur”, me vlerë limit të kontratës në shumën 129,684,651 lekë pa TVSH dhe në shumën 143,444,390 lekë me TVSH, burimi i financimit nga buxheti i shtetit, nëpërmjet projekteve të artit dhe kulturës të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas Vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.5, datë 09.02.2015 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.2506/2, datë 18.02.2015.

##### **Financimi sipas burimit:**

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 143,444,390 lekë

##### **Financimi sipas periudhave:**

- Në vitin 2015 100,411,073 lekë;
- Në vitin 2015 43,033,317 lekë;
- **Totali: 143,444,390 lekë**
- **Fondi limit 143,444,390 lekë**

Sa më sipër, nga AK Bashkia Korçë është vepruar në përputhje me LPP, me ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me ndryshime Kapitulli III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika nr. 140, ku cilësohet:

*Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.*

##### **2. Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit:**

##### **Procedura me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës”**

<b>Të dhëna mbi procedurën</b>		
Urdhër Prokurimi nr. 42, datë 31.07.2015	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 42, datë 31.07.2015	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrit nr. 42/1, datë 31.07.2015
Lloji i Procedurës së prokurimit: “Tender i hapur”	1.Matilda Stena 2.Merita Buci 3.Bujar Meta	1.Benila Themeli, Kryetar 2.Olvas Petro, Anëtar 3.Kiço Koço, Anëtar



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

		4.Leonard Gjançi, Anëtar 5.Henri Nune, Anëtar
Fondi limit: 129,684,651 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 126,121,250 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 3,563,404 lekë
Data e hapjes së procedurës: 27.08.2015 ora 11.00 shtyre në datë 04.09.2015 ora 11.00	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit Fondi i zhvillimit të rajoneve	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 3 (tre) OE b. Kualifikuar: 1 (një) BOE c. S'kualifikuar: 2 (dy) 1OE dhe 1BOE
Ankimime: 1 OE "REJ" SH.P.K. mbi DT (shtojca 20)	Përgjigje ankesës nga AK.: shkresa nr.6111 Prot. Dt 112.8.2015	Përgjigje ankesës nga KPP: -s'ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

#### **2.1.Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike:**

Me shkresën nr. 536/4, datë 02.03.2015 FSHZH i ka dërguar Bashkisë Korçë, projektin teknik për objektin "Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar", Bashkia Korçë.

Në bazë të këtij projekti janë përcaktuar dhe hartuar Specifikimet teknike, nga "Dea Studio" SHPK kontraktuar nga Bashkia Korçë; Projekti dhe Raporti i instalimeve mekanike nga Ing. Spiro Drita, kontraktuar nga Bashkia Korçë; Projekti dhe Raporti mbi instalimet elektrike nga Ing. Dëshira Mena kontraktuar nga Bashkia Korçë, Raport mbi Oponencën teknike të kryer nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkititekturës dhe Urbanistikës, dërguar me shkresë nr. 115, datë 04.05.2015, Grafiku i punimeve dhe Preventivi.

#### **2.2.Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën "Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës"/"Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar".

#### **Gjetje nga auditimi:** Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta

**Situata:** Njësia e Prokurimit në hartimin e "Kriterëve të veçanta të kualifikimit/Kapaciteti Teknik" në lidhje me "Disponimin e mjeteve" pika 4 (DT) ka kërkuar "mjet transporti" copë 2, pa përshkruar karakteristikat teknike të mjetit të kërkuar si: lloji i mjetit, tonazhi, fuqia etj.

**Kriteri:** Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 26 "Kontrata e punëve", pika 8 ku cilësohet: "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon*", germa c, "*Për përmbushjen e kriterëve për kualifikim duhet të paraqiten dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*".

**Shkaku:** Mosveprim i NJP

**Ndikimi:** Mund të ndikojë në përmbushjen e kontratës.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** (Trajtuar më lart si rekomandim)

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, si personat përgjegjës sipas VKM nenit 57 "Njësia së Prokurimit".

#### **2.3.Mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.**





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Nga OE “DK” SHPK, i kontraktuar nga AK janë përcaktuar specifikimet teknike dhe është përlloritur vlera limit e kontratës sipas Preventivit në shumën 143,444,390 lekë me TVSH dhe 129,684,651 lekë pa TVSH.

#### **2.4.Hartimi dhe miratimi i Dokumenteve të Tenderit (DT)**

Nga Njësia e Prokurimit (NJP), janë hartuar dhe miratuar DT me Procesverbalin nr. 1, datë 31.07.2015. Procesverbali është firmosur nga të gjithë anëtarët e NJP. Gjithashtu nga NJP është hartuar seti i plotë i DT, të cilat janë firmosur në çdo faqe nga NJP. Pjesë e DT, janë të gjithë shtojcat e përcaktuara në DST.

**Konkluzion:** NJP ka vepruar në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nenin 57 “Njësia e prokurimit” dhe nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 1, ku cilësohet:

*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit.*

#### **2.5.Mbi vlerësimin e ofertave**

Në vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës”/“Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, konstatohet se: OE pjesëmarrës janë 3:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “Kevin Konstruktion” SHPK	101,930,750
2	BOE “BELADI & BEQARI” SHPK	114,123,305
3	BOE “K &XH” SHPK	126,121,246

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

BOE në Akt-Marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 2071 rep., datë 02.09.2015, janë shprehur se pjesëmarrja do të jetë në raportet:

- “K” SHPK 80 % të punimeve, ose në vlerë 111,579,682 lekë;
- “XH” SHPK 20 % të punimeve, ose në vlerë 27,894,921 lekë.

Raportet e mësipërme të pjesëmarrjes në zëra punimesh referuar preventivit të këtij objekti do të jenë:

- “K” SHPK 80 % të punimeve të mbetura në preventiv;
- “XH” SHPK 20 % të punimeve:

Kapitulli I: Pika 3, punime murature; Pika 4, punime betoni dhe betonarme; Pikën 5, punime hekuri; Kapitulli III, Punime mekanike dhe nga Kapitulli V, Pika 2 Kuadri kryesor i shërbimeve mekanike rrjeti.

Nga KVO sipas Procesverbalit nr. 3, datë 14.09.2015, është kryer shqyrtimi i ofertave dhe ka rezultuar si më poshtë:

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	OE “Kevin Konstruktion” SHPK	101,930,750
2	BOE “BELADI & BEQARI” SHPK	114,123,305



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

OE “Kevin Konstruksion” dhe BOE “BELADI & BEQARI” janë skualifikuar nga KVO pasi nuk plotësonin kriteret për kualifikim, gjithashtu OE “Kevin Konstruksion” kishte gabime aritmetike në ofertë të cilat kalojnë 2%, pasi shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta dhe automatikisht kjo ofertë është refuzuar. Veprim në përputhje me DT Seksioni 3 “Vlerësimi i ofertave”, pika 3.2 “Korigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra”, ku cilësohet:

*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

**OE i kualifikuar:** BOE “K” SHPK & “XH” SHPK është kualifikuar.

Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin e paraqitur nga ky bashkim operatorësh konstatohet se:

**Gjetje nga auditimi:** Mbi mosplotësimin e kriterëve nga OE “K”

**Situata 1:** Gjithashtu, ky operator nuk përmbush kriteret e veçanta për kualifikim/kapaciteti ekonomik-financiar, pasi deklarata mbi gjendjen financiare datë 01.09.2015, konfirmon gjendjen në vlerën 8,326,600 lekë, e cila është më e ulët se 80 % e 10% të fondit limit ( $129,684,651 * 10 \% = 12,968,465 * 80 \% = 10,374,772$  lekë).

**Situata 2:** Nga subjekti i audituar është pretenduar se, meqë kapaciteti financiar në total plotësohet nga BOE, dhe kriteret e tjera janë plotësuar e kanë vlerësuar “devijim të vogël”. Këtë qëndrim të tyre, KVO nuk e ka dokumentuar në Procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

**Kriteri 1:** DT pika 2.1 “Kapaciteti ekonomik-financiar” pika 2 ku cilësohet: *Një çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka me vlere jo me te ulët se 10% e fondit limit.*

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 74 “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë”, pika 3, ku cilësohet: “...kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

DT “Kriteret e veçanta për kualifikim”, pika 4.

**Kriteri 2:** LPP, neni 12.

**Shkaku:** Mosveprim i KVO

**Ndikimi:** Mund të ndikojë në afatin e përmbushjes së kontratës.

**Rëndësia:** E ulët

**Rekomandimi:** -

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë observacionin e subjektit të audituar, mbi vlerësimin e ofertave, theksojmë se nga ana e saj KVO, nuk ka lënë gjurmë për qëndrimin e saj në rastin e sipërcituar, duke vepruar në kundërshtim me LPP neni 12 “Përgjegjësitë e AK”.

**Për veprimet dhe mosverimet e mësipërme mban përgjegjësi:** KVO, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 58.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

#### **2.6. Mbi shpalljen e fituesit dhe lidhjen e Kontratës**

Nga AK është shpallur fitues BOE “K” SHPK & “XH” SHPK. Nga KVO është hartuar dhe miratuar nga TAK Raporti përmbledhës. Nga AK është plotësuar Formulari i Njoftimit të fituesit datë 22.09.2015 i cili është botuar në Buletinin e APP-së nr. 38, datë 28.09.2015. Midis AK dhe BOE është nënshkruar Kontrata datë 08.10.2015 si dhe është dorëzuar Formular i Sigurimit të Kontratës para lidhjes së saj. Nga AK është plotësuar “Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar” si dhe Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës, publikuar në Buletinin e APP-së nr. 41, datë 20.10.2015.

**Konkluzion:** Në lidhjen e Kontratës dhe publikimin e saj nga AK janë zbatuar afatet e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

#### **3. Përmbajtja/dokumentacioni i dosjes së prokurimit:**

**Konkluzion:** Nga aditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit rezultoi se NJP ka administruar të gjithë dokumentacionin e duhur, në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, neni 57 “Njësia e prokurimit”.

#### **4. Mbi likuidimin e situacioneve pjesore dhe atij përfundimtar:**

Kontrata e sipërmarrjes me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” është lidhur midis BOE dhe Bashkisë Korçë, datë 08.10.2015.

Kontrata me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” me vlerë 139,474,603 lekë me TVSH, ka afat maksimal të përfundimit të punimeve 6 muaj, si dhe ka përfunduar më datë 08.04.2016 sipas Njoftimit të Mbikëqyrësit të punimeve, cilësuar në Aktin e kolaudimit datë 28.04.2016 të nënshkruar nga:

- Kolaudator objekti: “Pandi Strejanaj”
- Mbikëqyrësi i punimeve: “DS” SHPK
- Sipërmarrës: “K” SHPK

*Mbi respektimin e afatit të realizimit të kontratës.*

Data e fillimit të punimeve: 08.10.2015

Data e përfundimit të punimeve: 08.04.2016

Kryerja e punimeve është realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Nr.	Urdhër shpenzimi		Situacioni		Vlera	Garanci punimesh 5%	Likuiduar
	Numër	Data	Numër	Datë			
1	978	02.12.2015	1	26.11.2015	55,934,137	2,796,707	53,137,430
2	1126	29.12.2015	2	26.12.2015	44,476,936	2,223,847	42,253,089
3	295	04.04.2016	3	15.03.2016	13,304,292	665,215	12,639,077
4	866	26.08.2016	P/4	08.04.2016	23,985,985	1,199,299	22,786,686
7					<b>137,701,350</b>	<b>6,885,068</b>	<b>130,816,282</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Punoi: KLSH

Garancia e punimeve në vlerën 6,885,068 lekë, i është likuiduar BOE sipas Urdhër shpenzimit nr. 623, datë 09.07.2018, bazuar në Urdhër e TAK nr. 409, datë 06.07.2018, Certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve, datë 18.06.2018, Situacionin përfundimtar datë 08.04.2016 dhe Akt kolaudimin, datë 28.04.2016 të nënshkruar nga Mbikëqyrësi i punimeve, Sipërmarrësi i punimeve



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

dhe Kolaudatori, në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 22.02.2005, si dhe pas përfundimit të afatit 2 vjeçar të garancisë.

**Konkluzion:** Drejtoria e Financës, ka vepruar në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe VKB nr. 5, datë 12.01.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017”.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1 dhe 2, datë 06.09.2019, protokolluar në subjekt me nr. 6920/1 dhe 6920/2, datë 06.09.2019, si dhe është trajtuar në faqet 10-27 të Projektraportit të Auditimit.**

**Nga subjekti i audituar mbi Aktkonstatimin nr. 1, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 6920/6, datë 12.09.2019 dhe mbi Projektraportin e Auditimit është paraqitur observacioni me shkresë nr. 6920/11, datë 07.10.2019, protokolluar në KLSH me nr. 495/4, datë 14.10.2019, për sa më poshtë vijon:**

#### **1. Pretendimi i subjektit:**

*a. Lidhur me konstatimin e audituesve se “Nga NJP nuk është kërkuar në DT, dokumentacioni mbi përmbushjen e specifikimeve teknike për materialet e mëposhtme: Veshje fasade dhe Profilët e aluminit ju sqarojmë se:*

*Pjesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit është edhe “Deklarata mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5” e cila është një nga garancitë që autoriteti merr paraprakisht për përmbushjen e specifikimeve teknike. Pra ka një dokument të kërkuar për përmbushjen e specifikimeve teknike.*

*Pavarësisht nëse kërkohen apo jo paraprakisht dokumentacioni për materialet që do të përdoren në zbatim kontraktori është i detyruar ti dorëzojë ato gjatë zbatimit të kontratës.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*b. Përsa keni observuar në germën b, nga ana juaj nuk janë paraqitur argumente ligjore, është thjesht interpretim. Në VKM cilësohet: “Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve, që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera, që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës. **Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46, të LPP-së. Këto duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës**”. Nëpërmjet kriterëve të veçanta për kualifikim kërkohet që OE pjesëmarrës para kualifikimit duhet të paraqesin dokumentacionin e specifikuar për të vertetuar aftësitë e tyre sipas rastit. Është analizuar faza e procedurës së prokurimit dhe jo e zbatimit të kontratës. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

#### **2. Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me piken 2.3. “Mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës” ju sqarojmë si më poshtë vijon:*

*a. Lidhur me mungesën e urdhrit për ngritjen e grupit të punës sqarojmë se: Pjesë e strukturës të Bashkisë Korçë është edhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Teritorit një nga detyrat funksionale të së cilës sipas rregullores të organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Korçë është edhe hartimi projekteve dhe preventivave për këtë arsye nuk ka një urdhër të veçantë për caktimin e ketyre detyrave.*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

*b. Lidhur me mangësitë e kostatuara në analizat e çmimeve në disa zëra të preventivit sqarojmë se: Lidhur me zërin “Veshje fasade me pllaka guri” dhe “Veshje xokoli me pllaka guri” sqarojmë se nuk i kemi referuar manualit për shkak se guri i përdorur për veshjen e fasades dhe xokolit është gur me karakteristika të zonës dhe me trashësi më të madhe se ajo standarte me qëllim që ti rezistojë kushteve atmosferike. Lidhur me diferencën ndërmjet analizës dhe cmimit të shënuar në preventiv ju sqarojmë se behet fjalë për një lapsus të bërë në analizën e çmimit. Ndërsa lidhur me zërin “Shtrese me pllaka guri te cukitur” nuk janë përdorur dy standarte por bëhet fjalë për pllaka guri me trashësi të ndryshme. Në zërat “Veshje fasade me pllaka guri” dhe “Veshje xokoli me pllaka guri” trashësia është dy fish më e madhe se tek zëri “Shtrese me pllaka guri te cukitur”.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*a. Për sa keni observuar në germën a, pretendimi juaj nuk qëndron. Rregullat e prokurimit shprehen qartë se në rastet kur NJP, nuk ka kapacitet e nevojshme, për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriterëve apo vlerës limit të kontratës, TAK është ai që ngre grupet e punës dhe përcakton në mënyrë nominative anëtarët e tyre.*

*b. Për sa keni observuar në germën b, observacioni juaj është trajtuar me vëmendje, si dhe është pranuar pjesërisht për sa i takon zërit të punimeve “Veshje fasade me pllaka guri”, për të cilin në DT “Specifikimet teknike” ishte përcaktuar se trashësia e gurit duhet të jetë  $t=10$  cm, për rrjedhojë edhe çmimi i përcaktuar në Analizën teknike në vlerën 5,500 lekë është argumentuar. Pë këtë arsye për zërat e punimeve të paraqitur më poshtë janë trajtuar në mënyrë të veçantë në RPA, për shkak se në DT “Specifikimet teknike”, përveç pllakave të gurit “për veshje fasade” për të cilat ishte specifikuar se trashësia e gurit duhet  $t=10$  cm, për zërat e tjerë nuk kishte specifikime të veçanta, si dhe në Preventiv nuk është përcaktuar trashësia e tyre. Për rrjedhojë u rillogaritën diferencat të cilat janë reflektuar në RPA.*

Zëri	Preventiv	An/Man	Dif/çmim	Sasia	Diferenca në vlerë
Veshje fasade me pllaka guri	8,000	5,500	2,500	813	2,032,500
Veshje tarrace me pllaka guri	7,800	3,399	4,401	153	673,353
Veshje xokoli me pllaka guri	8,000	3,399	4,601	153	703,953
					<b>3,409,806</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Punoi: KLSH

### **3. Pretendimi i subjektit:**

*a. Lidhur me konstatimin se “Për zërin punime mekanike” 2.261 dhe 2.1 kanë rezultuar diferenca midis preventivit dhe Manualit Nr.2 Nuk kemi argumentim për vendosjen e çmimit 1376 lek/njësi dhe 602 leke/njësi në preventiv” sqarojmë se nuk ka diferenca pasi në manual çmimet janë 1376 dhe 602 siç janë shënuar edhe në preventiv. Bashkelidhur kopje nga manuali i çmimeve i vitit 2013.*

*b. Për zërin “Antene rrufepritese me shtyllë e kompletuar me aksesoret dhe mates statistikor” ka analizë çmimi. Bashkelidhur një kopje e analizës.*

*c. Për zërat “FV. bordura guri te cukitur” dhe “Ndertim kupole me xhami termik opak”, duke qënë se është bërë një lapsus në shënimin e referencës nga manuali kur në fakt çmimet nuk janë nga manuali analizat e çmimeve gabimisht nuk i janë bashkelidhur preventivit të dorëzuar për prokurim. Bashkelidhur analizat e çmimeve.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

*a. Për sa keni observuar në germën a, observacioni juaj pranohet dhe është reflektuar në RPA. Në Manualin nr. 2 “Analiza teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, është përcaktuar: Zëri i punimeve 2.1, kosto totale 586 lekë/m<sup>3</sup> dhe jo 602 lekë/m<sup>3</sup>. Nga ana juaj sipas përshkrimit duhet ti referoheshit zërit të punimeve 2.15, ndërsa në preventiv është cituar zëri 2.1, i cili ka vlerën 586 lekë/njësi.*

*b/c. Për sa keni observuar në germën b dhe c, observacioni juaj pranohet, pasi bashkëngjitur observacionit janë analizat e çmimeve. Theksojmë se, nuk ka një përputhje për disa zëra punimesh, midis përshkrimeve në analizën e koston dhe preventiv.*

**Gjithashtu nuk ka analizë kostoje për disa zëra (18 raste) për të cilët nuk i jeni referuar manualeve. Për sa i përket analizave të çmimit bashkëngjitur observacionit, nuk merren në konsideratë. Dokumentacioni i përgatitur aktualisht nga ana juaj dhe paraqitur bashkëngjitur observacionit nuk është pjesë e këtij vlerësimi. Ato nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të paraqitur, bashkëngjitur preventivit të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe pjesë e dosjes së tenderit. (Shembujt janë reflektuar në RPA dhe Pasqyrën anekse nr. 2).**

#### **4. Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me piken 2.5. “Mbi vlerësimin e ofertave” ju sqarojmë si më poshtë vijon:*

*Lidhur me plotësimin e kriterit për xhiron dhe çertifikatat ISO të bashkimit të shoqërive “EK” SHPK dhe “M” SHPK sqarojmë se:*

*a. Në kriteret e vendosura në DT është kërkuar: “1. Xhironja mesatare vjetore gjatë 3(tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë sa vlera e fondit limit. Kjo do të vertetohet duke paraqitur vertetim për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit leshuar nga administrata tatimore”*

*Vlera e fondit limit është =49,968,529 lekë.*

*Duke qënë se ky kriter përmbushet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, KVO ka vlerësuar se fakti që xhironja mesatare e shoqërisë M SHPK është pak më e ulët referuar me përqindjen e pjesëmarrjes në punë përbën “devijim të vogël” në kuptim të përcaktimit të bërë në nenin 53 pika 4 te LPP dhe nuk ndikon në zbatimin e kontratës.*

*b. Në kriteret e vendosura në DT është kërkuar praqitja e 4 certifikatve ISO.*

*Shoqëria “EK” SHPK e cila ka marrë 30% të punimeve ka paraqitur 2 prej tyre:*

*Duke qënë se ky kriter përmbushet nga i gjithë grupi i marrë së bashku dhe në kushtet kur shoqëria EK” SHPK ka marrë 30% të punimeve KVO e ka vlerësuar këtë “devijim të vogël” në kuptim të përcaktimit të bërë në nenin 53 pika 4 te LPP dhe nuk ndikon në zbatimin e kontratës.*

*Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj se në rast se do të skualifikohej ky ofertues atëherë rrjedhimisht do të shpallej fitues ofertuesi pasardhës i kualifikuar “XH SHPK dhe Curri SHPK” i cili ka një diferencë prej 2.6 milion lekësh më tepër nga oferta e kualifikuar nga KVO. Duke patur këtë diferencë të konsiderueshme monetare përballë disa mangësive jo thelbësore (referuar edhe rekomandimeve të vazhdueshme të KLSH për vlerësimin e devijimeve të vogla) KVO ka vendosur të kualifikojë bashkimin e operatoreve “M SHPK dhe EK SHPK”.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*a. Kontrata e bashkëpunimit ka përcaktuar ndarjen e plotësimin të kriterëve, në rastin konkret të kapaciteteve ekonomiko-financiare, në po të njëjtën përqindje, 70 % “M” SHPK dhe 30 % “EK” SHPK të plotësohet nga të dy OE.*

*b. Sa më sipër sqarojmë se sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit është cilësuar se OE “EK”, do të marrë pjesë në realizimin e kësaj kontrate në masën 30 %, për të gjithë spektrin e zërave të punimeve të përcaktuara në preventiv, për rrjedhojë dokumentacioni i cili vërteton aftësitë për*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

realizimin e kësaj kontrate në tërësi duhet të plotësohet edhe nga OE "EK" SHPK. Pra "EK" SHPK, duhet të paraqiste 4 certifikatat ISO të kërkuara në DT.

Gjithashtu ju sqarojmë se, asnjë prej kriterëve të mësipërme, në procesverbalin e vlerësimit të ofertave nuk është trajtuar si i papërbushur, apo i vlerësuar dhe gjykuar nga KVO me argumente si "devijim i vogël". KVO duhet të lerë gjurmë për çdo argumentim, vlerësim dhe vendim që merr në procesin e vlerësimit të ofertave.

Përsa i përket "devijimit të vogël" sqarojmë se së pari, sipas LPP vlerësohen ofertat e kualifikuara referuar çmimit më të ulët, pra ato që kanë plotësuar kriteret për kualifikim; së dyti edhe referuar KLSH, ju filsni për "devijime të vogla", por nga KVO nuk kemi anjë trajtim të tillë.

**Nga subjekti i audituar mbi Aktkonstatimin nr. 2, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 6920/7, datë 12.09.2019 dhe mbi Projektraportin e Auditimit është paraqitur observacioni me shkresë nr. 6920/11, datë 07.10.2019, protokolluar në KLSH me nr. 495/4, datë 14.10.2019, për sa më poshtë vijon:**

#### **Pretendimi i subjektit:**

**a. Mbi disponimin e mjeteve te është kërkuar:** "Per disponimin e te gjitha mjeteve te mesiperme ofertuesit duhet te paraqesin nje deklarate mbi disponimin e makinerive sipas shtojces 9."

1.Ne VKM Nr 1 datë 10.01.2007, Kreu III "Dokumentet e tenderit",pika 3 "Informacione te vecanta",germa a "Kontratat për pune përcaktohet shprehimisht se: "Autoriteti kontraktor **mund t'u kërkojë** operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmitë e mëposhtme, që vërtetojnë se ai i plotëson kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".

**b. Lidhur me objektin e aktivitetit te shoqërisë "K" SHPK bashkëlidhur do të gjeni Vendimin Nr. 1232 datë 01.02.1994 të Gjykatës të Rrethit Tiranë "Për regjistrimin si person juridik " nga ku rezulton se objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie nuk është vetëm "Prodhimi i materialeve të ndërtimit" por përfshin cdo aspekt ndërtimi. Bashkëlidhur do të gjeni vendimin Nr 1232 datë 01.02.1994 i shkarkuar nga faqja [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).**

Gjithashtu shoqëria K SHPK është një kompani me qëndër në qytetin e Korçës, e cila është pajisur historikisht me leje ndërtimi nga bashkia Korçë dhe ka ndërtuar shumë objekte rezidenciale banimi, fakt për të cilin ne jemi në dijeni.Për më tepër që kjo shoqëri bazuar në Liçencën Nr 2444/7 lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Liçencave Profesionale për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore zbatuese,është liçensuar për Ndërtime civile dhe industriale,Rikonstruksion godinash, punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, etj. Bashkëlidhur Liçenca Nr 2444/7.

**c. Lidhur me plotësimin e kriterit për gjëndjen financiare ju sqarojme se:**

-Në kriteret e vendosura në DT është kërkuar:

"Një certifikatë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka me vlere jo me te ulet se 10% e fondit limit, leshuar jo me pare se data 21.08.2015."

**Vlera e fondit limit është** = 129.684.651 lekë X 10 %=12,968,465 lekë.

Vërtetimi i paraqitur nga shoqëria K sh.p.k është me vlerë= 8.326.000 lekë

Vërtetimi i paraqitur nga shoqëria XH sh.p.k është me vlerë =25.108.904 lekë

Duke qënë se ky kriter përmbushet dhe tejkalohet nga i gjithë grupi i marrë së bashku, KVO ka vlerësuar se fakti që vlera e gjëndjes financiare të shënuar në vërtetimin e shoqërisë K SHPK është pak më e ulët referuar me përqindjen e pjesëmarrjes në punë përbën "devijim të vogël" në kuptim të përcaktimit të bërë në nenin 53 pika 4 te LPP dhe nuk ndikon në zbatimin e kontratës.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Duke konsideruar këtë mangësi jo thelbësore (referuar edhe rekomandimeve të vazhdueshme të KLSH për vlerësimin e devijimeve të vogla) KVO ka vendosur të kualifikojë bashkimin e operatoreve “Konstruskon 93” SHPK dhe “XH” SHPK.

d. Lidhur me mosparaqitjen e skedave teknike për produktet lesh guri dhe vida, bashkëngjitur keni dokumentacionin e paraqitur nga BOE.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

a. Pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë. Veprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 26 “Kontrata e punëve”, pika 8 ku cilësohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon”, germa c, “Për përmbushjen e kriterëve për kualifikim duhet të paraqiten dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

b. Për sa keni observuar në germën b, observacioni juaj merret në konsideratë dhe është reflektuar në RPA, pasi bashkëngjitur observacioni është Vendimi i Gjykatës mbi Regjistrimin person juridik, ku në objektin e veprimtrasisë citohet: “...prodhimin e materialeve të ndryshme që përdoren në fushën e ndërtimit, hartim preventivash dhe çdo aspekt tjetër në ndërtim...”

c. Për sa keni observuar në germën c, sqarojmë se, Kontrata e bashkëpunimit ka përcaktuar ndarjen e plotësimin të kriterëve, në rastin konkret të kapaciteteve ekonomiko-financiare, në po të njëjtën përqindje, 20 % “XH” SHPK dhe 80 % “K” SHPK, pra 10,374,772 lekë dhe ka paraqitur vërtetim për 8.326.000 lekë. Gjithashtu, ju sqarojmë se, në procesverbalin e vlerësimit të ofertave nuk është trajtuar si i papërmbushur, apo i vlerësuar dhe gjykuar nga KVO me argumente si “devijim i vogël”. KVO duhet të lerë gjurmë për çdo argumentim, vlerësim dhe vendim që merr në procesin e vlerësimit të ofertave.

d. Pretendimi juaj i cituar në germën d, qëndron dhe është reflektuar në RPA. Nga subjekti bashkëngjitur observacionit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Certifikatë konformiteti nr. K1-0751-CPD-233.0-01/08 E, për produktin “lesh guri/mineral”;

Deklaratë performance me referencë KUS-0415, për produktin “vida”.

## **5. Mbi zbatimin e kontratave:**

### **5.1.Ndërtim i objektit “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, Bashkia Korçë**

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, Bashkia Korçë			
14.Lidhja e kontratës Pa numër protokollit, datë 16.10.2014	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 49,302,685 lekë BOE fitues “M” SHPK & “EK” SHPK		16.Likuiduar deri më datë 16.12.2015 vlera prej <b>49,302,685 lekë me TVSH</b>
17- Situacioni Përfundimtar është likuiduar datë 16.02.2019 në vlerën 46,837,551 lekë dhe Garancia e punimeve në vlerën 2,465,134 lekë, i është likuiduar BOE më datë 07.11.2017.	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 180 ditë, Zbatuar 323 ditë. Fillimi punimeve: 17.10.2014 Perfundimi punimeve : 05.09.2015		19. Zgjatja e kontratës 1. Pa numër prot, datë 10.12.2014, deri në 10.05.2017; 2. nr. 2136, datë 20.07.2015, deri në 25.08.2015
20. Mbikëqyrësi i punimeve “Infraconsult” SHPK	Licenca nr: MK 2237/1	Kontrata pa numër prot., datë 16.10.2014	
21. Kolaudatori i punimeve OE “Novatech Studio” SHPK	Licenca nr: MK 1846/5	Kontrata pa numër prot., datë 08.05.2015	





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

22.Akt Kolaudimi datë 10.10.2015	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 10.10.2015	
----------------------------------	---	--

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume. U konstatua se janë kryer punime suvatimi të jashtme mbi shtresën e pllakës së veshjes, e cila nga kqyrja e fotove të administruara në dosje, rezulton të jetë kryer totalisht.

**Gjetje nga auditimi:** Mungesa të zërave në librin e masave të hartuar në zbatimin e objektit “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, Bashkia Korçë, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues “M” SHPK & “EK” SHPK, për zërat e punimeve 7.4, 10.3, 10.4 dhe 10.5.

**Situata 1:**

- Projekti i zbatimit, sipas të cilit është zhvilluar ky objekt, rezulton të jetë me mangësi. Projekti i mbrojtjes nga zjarri, i furnizimit me ujë sanitar, i shkarkimit të ujërave të përdorur, i shkarkimit të ujërave atmosferik, projekti elektrik dhe i ndriçimit janë marrë nga projektidea e bërë nga shoqëria “Dea” SHPK për objektin “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, faza II-të, i prokuruar për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

**Situata 2:**

- Ka rezultuar se për 4 zëra pune, nuk administrohet librezja e masave. Këto zëra janë:

- 7.4. Veshje faqet e brendshme të dritareve;
- 10.3. Zgara metalike me  $d=8\text{mm}/20\text{ cm}$
- 10.4 FV bordura guri të çukitur  $8 \times 15\text{ cm}$
- 10.5 Shtresë me pllaka guri të çukitur  $t=4\text{ cm}$ .

**Situata 3:**

- U konstatua se janë kryer punime suvatimi të jashtme mbi shtresën e pllakës së veshjes, e cila nga kqyrja e fotove të administruara në dosje, rezulton të jetë kryer totalisht.

**Kriteri 2:**

Situacionimi i volumeve pa hartuar librin e masave, si dokumenti bazë për kontrollin e volumeve të punimeve, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot datë 16.04.2014.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot datë 16.04.2014.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve pa nr. prot, datë 08.05.2015.

**Ndikimi/Efekti:**

Nuk ka pasuar efekte.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e dosjes teknike të zbatimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

- Rëndësia:** E ulët.
- Rekomandim 1:** Nga Bashkia Korçë të merren masa që objektet që prokurohen të jenë të pajisur me projektin e plotë të zbatimit të punimeve, për të shmangur problemet gjatë zbatimit të punimeve dhe ndryshimet e panevojshme.
- Rekomandim 2:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit dhe nga mbikëqyrësi e kolaudatori i punimeve, të verifikohet me përgjegjësi përmbajtja e dosjes teknike, me të gjithë elementët e saj.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 06.09.2019, protokolluar në subjekt me nr. 6920/4 datë 06.09.2019, si dhe është trajtuar në faqet 31-33 të Projektraportit të Auditimit.**

Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** z. S.M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe z. E.N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

#### 5.2. Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit;
- Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar;
- Situacioni përfundimtar;
- Librezat e masave, etj.

#### Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës Punimeve			
14. Lidhja e kontratës bazë datë 08/10/2015 midis Bashkisë Korçë përfaqësuar nga z. Sotiraq Filo dhe sipërmarrësit BOE "K" shpk & "XH" shpk përfaqësuar nga znj. Lida Qiraxhi dhe z. Ali XH.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 139,474,603 lekë.	16. Likuiduar deri në datë 26.08.2016, vlera prej 137,701,350 lekë me TVSH.	
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Situacioni përfundimtar datë 08.04.2016 Likuiduar deri më datë 26.08.2016 vlera totale 130,816,282 lekë dhe Garancia e punimeve në vlerën 6,885,068 lekë, i është likuiduar BOE më datë 09.07.2018.	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar: 6 muaj . Fillimi punimeve: 08.10.2015 Përfundimi punimeve: 08.04.2016 Realizimi: 3 muaj (90 ditë)	19. Leje ndërtimi për punimet e objektit. Nr. 10 datë 16.10.2014 e Kryetarit të Bashkisë Korçë. Projekti i realizuar nga "Dea Studio" shpk	
20. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë datë 19.01.2015 "Për projektim dhe mbikëqyrje" midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit përfaqësuar nga z. Benet Beni dhe BOE "Dea-Studio" & "Infrakonsult" shpk.	Licenca Nr: MK.2237/1	Kontrata Nr. Prot. datë datë 19.01.2015	
21. Kolaudatori i punimeve Lidhur kontratës datë 10.04.2016. Kryetari i Bashkisë z. Sotiraq Filo dhe z. Pandi Sterjanaj, me vlerë 138,000 lekë me tvsh.	Licenca Nr: MK 2632	Kontrata Nr. Prot. datë	
22. Akt Kolaudimi	23. Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka	24. Fletë Hyrja (për mallrat)	



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Datë 28.04.2016

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

**I.** Projekti është prokuruar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe është realizuar nga “DS” & “Infrakonsult” shpk.

**II.** Projektit i është bërë oponente teknike Nr.115/1 datë 04.05.2015 nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, ku shprehet se: Projekti është realizuar në përputhje me standardet e projektimit, termave të referencës dhe detyrës së projektimit si dhe plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Projekti plotëson kërkesat urbanistike si dhe kërkesat specifike që kërkojnë ndërtesat civile në Republikën e Shqipërisë.

**III.** Nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit të objektit u konstatua se mungonte:

Nga verifikimi në objekt u konstatua se nuk janë kryer punime ndërtimi të cilat rezultojnë të paguara në situacionin me vlerë **366,667 lekë pa TVSH.** (Tabela 1).

	Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe provimovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar	Njësia	Çmimi	Sasia Situacion	Sasia Faktike	Diferanca	Diferenca
Zëri	Emërtimi		Lekë	Njësi	Njësi	Sasi	Lekë
<b>7</b>	<b>Punime Shtresash</b>						
1	Shtrese betoni industriale t=22cm beton rck 30 i armuar me fibra	m2	5300	515	505.9	9.058	48,004.80
2	F.v Dysheme rezine ne ambientet nëntokësore	m2	5400	515	505.9	9.058	48,910.50
<b>11</b>	<b>Punime bojatisje</b>						
10	Patinim + Lyerje me bojë ALBUS 198 (Kodi 02B)	m2	620	2113	1677.9	435.08	269,751.20
	Vlera Diferenca						<b>366,666.00</b>
	<b>TVSH</b>						<b>73,333.00</b>
	<b>SHUMA TOTALE</b>						<b>440,000.00</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH

#### Përkatësisht për:

- Zërin 7.1 Shtrese betoni industriale t=22cm beton rck 30 i armuar me fibra. Nga verifikimi në objekt, projektit, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar konstatohet se shtresa e betonit industrial t=22cm beton rck 30 i armuar me fibra është kryer në sasinë 505.9 m2 (paraqitur në anekse), ndërsa në situacion dhe librezë masash është paguar në sasinë 515 m2. Diferenca prej 9.058 m2 është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.
- Zërin 7.2 F.v Dysheme rezine ne ambientet nëntokësore. Nga verifikimi në objekt, projektit, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar konstatohet se dyshemeja rezine ne ambientet nëntokësore është kryer në sasinë 505.9 m2 (paraqitur në anekse), ndërsa në situacion dhe librezë masash është paguar në sasinë 515 m2. Diferenca prej 9.058 m2 është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.
- Zërin 11.10 Patinim + Lyerje me bojë ALBUS 198 (Kodi 02B). Nga verifikimi në objekt, projektit, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar konstatohet Patinim + Lyerje me bojë ALBUS 198 (Kodi 02B) është realizuar në sasinë 1677.9 m2 (paraqitur në anekse), ndërsa



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

në situacion dhe librezë masash është paguar në sasinë 2113 m<sup>2</sup>. Diferenca prej 435.08 m<sup>2</sup> është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

**Gjetje nga auditimi:** Punime të pakryera por të paguara në situacionin përfundimtar.

**Situata:** Nga verifikimi në objekt u konstatua se nuk janë kryer punime ndërtimi të cilat rezultojnë të paguara në situacionin me **366,666 lekë pa TVSH, të cilat janë:**

7.1 Shtrese betoni industriale t=22cm beton rck 30 i armuar me fibra.

7.2 F.v Dysheme rezine ne ambjentet nëntokësore.

11.10 Patinim + Lyerje me bojë ALBUS 198 (Kodi 02B).

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve të pakryera, libri i masave, si dokumente bazë për kontrollin e volumeve të punimeve, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot datë 08/10/2015.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve pa nr. prot, datë 10.04.2016

**Ndikimi/Efekti:** **366,666 lekë pa TVSH**

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e volumeve/sasive të zbatimit të punimeve.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit dhe nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve, të verifikohet me përgjegjësi volumet/sasitë e kryera dhe përmbajtja e dosjes teknike, me të gjithë elementët e saj.

**IV. Nga verifikimi në objekt u konstatua se nuk ndodheshin të vendosur në objekt pajisje me vlerë 1,462,000 lekë pa tvsh paraqitur në tabelën e mëposhtme (Tabela 2):**

	Infrastruktura e brendshme e Qëndrës për ruajtjen dhe provimovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar	Njësia	Çmimi	Sasia Situacion	Vlera
Zëri	Emërtimi		Lekë	Njësi	Lekë
<b>VI</b>	<b>PAJISJE ELEKTRIKE</b>				
An	UPS, 15kVA cos=90, 3ph, 400/400v, 10 min	copë	1,030,000	1	1,030,000
An	Softëare dhe programin i sistemit te ndricimit sipas skenareve te kerkuar	copë	82,000	1	82,000
An	Suport projektori I motorizuar I integruar në tavan të varur (dhomë me shërbime të ndryshme). Modeli: SMART -LIFT Projektor me suport automatik, për tavan të varur	copë	350,000	1	350,000
	<b>VLERA</b>				<b>1,462,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë  
Punoi: KLSH



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

**Gjetje nga auditimi:** Mungesa e pajisjeve të vendosura në objekt por të paguara në situacionin përfundimtar.

- Situata:** Nga verifikimi në objekt u konstatua se nuk ndodheshin të vendosur në objekt pajisje me vlerë 3,091,500 lekë pa tvsh të listuara si më poshtë:
- UPS, 15kVA cos=90, 3ph, 400/400v, 10 min.
  - Softëare dhe programin i sistemit te ndriçimit sipas skenareve te kerkuar.
  - Suport projektori i motorizuar i integruar në tavan të varur (dhomë me shërbime të ndryshme). Modeli: SMART-LIFT Projektor me suport automatik, për tavan të varur.
- Kriteri:** Situacionimi i volumeve të pakryera, libri i masave, si dokumente bazë për kontrollin e volumeve të punimeve, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
  - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
  - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot datë 08/10/2015.
  - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve pa nr. prot, datë 10.04.2016
- Ndikimi/Efekti:** **1,462,000 pa TVSH**
- Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e volumeve/sasive të zbatimit të punimeve.
- Rëndësia:** I lartë.
- Rekomandime:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit dhe nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve, të verifikohet me përgjegjësi volumet/sasitë e kryera dhe përmbajtja e dosjes teknike, me të gjithë elementët e saj.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 06.09.2019, protokolluar në subjekt me nr. 6920/5 datë 06.09.2019, si dhe është trajtuar në faqet 33-36 të Projektraportit të Auditimit.**

**Nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 6920/12, protokolluar në KLSH me nr.495/4, datë 147.10.2019, për sa më poshtë vijon:**

#### **1. Pretendimi i subjektit:**

*Licenca e mbikëqyrësit të punimeve ndodhet bashkëlidhur materialit sqaruaes. Kontrata midis autoritetit kontraktor FSHZH dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “DEA Studio” shpk dhe “InfraKonsult” shpk ndodhet bashkëlidhur materialit sqarues. Kontrata midis autoritetit kontraktor FSHZH dhe bashkimit te operateve ekonomike “DEA Studio shpk” dhe “InfraKonsult shpk” ndodhet bashkelidhur materialit sqarues.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Këto pretendime merren në konsideratë.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

**2. Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me zberthimin e elementeve të strukturave metalike sipas dy zerave në preventiv japim sqarim/detajimet me poshte: Platformë + shkëlle metalike (dhoma Petersburg) dhe konstruksion metalik (dhoma Petersburg + kubi shkallëve + stoli + dhoma +Ikonosta).

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Ky pretendim merret në konsideratë.

**3. Pretendimi i subjektit:** **Zeri punime shtresash** 1.1 Shtrese betoni industriale T=22cm beton rck 30 i armuar me fibra. 1.2 F.V. dysheme rezine në ambjentet nëntokesore Sipas akt-konstatimit rezulton të jete një diference ndërmjet sipërfaqes së realizuar në veper (505.9m<sup>2</sup>) dhe atyre në librezën e masave (515m<sup>2</sup>) prej 9.058m<sup>2</sup>. Në fakt, siaps projektit, matjeve të hershme në veper, por edhe rimatjes pas akt-konstatimit rezulton që këto zera vlerën reale sipas matjeve në terren e kanë 515 m<sup>2</sup>. Duke mos njohur metodologjinë e matjes nga ekspertet dhe evidentuar në akt-konstatim mendojmë se kjo diference e pa marrë parasysh duhet të jete të një dhomë e vogël në katin -1 pjesë e dhomave të fondit të ikonave dhe nënshkalle (materializimi është aplikuar njëkohësisht dhe tek shkallet që lidhin katin e nëntokës me kuotën 0.00).

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Ky pretendim nuk merret në konsideratë, sepse matjet janë kryer sipas planimetrive dhe dimensioneve paraqitura në to, ku janë konsideruar të gjitha ambjentet e objektit.

**4. Pretendimi i subjektit:** Shtrese parketi, Gold Room sipas konstatimeve të aktit nr.4 eksperteve ju ka rezultuar të ketë një sipërfaqje prej 7.6m<sup>2</sup> më tepër (107.4m) të parketit të shtruar në dhomen Gold ndërmjet sipërfaqes së shtruar në veper dhe librezës së masave. Në fakt, sipas projektit matjeve, dhe rimatjes pas aktit të konstatimit drejtpërdrejt në veper rezulton të jenë 114.68 m<sup>2</sup> parketi i shtruar. Mund të jete e kuptueshëm keqkuptim në matje pasi sipas dimensioneve në fletën bazike të projektit (plani i katit për dhe në kuotën 0) dimensionet në dy dimensionet e mureve në dy orientimet e perëndrejtja është sipas konstatimit, por në projekt dhe e realizuar në veper rezulton një detaj arkitektonik i faqeve të mureve në perimetër, i shkeputet gipsi në 20cm. Parketi është shtruar deri në ekstremitete të kontureve të dhomes (poshte planeve vertikale të gipsit të cilat nuk shkojnë deri në dysheme) sikurse tregohet në fotot 3. Kjo duhet të jete edhe diferencë e përmendur në akt-konstatim nr. 4. Rezultoni të jete një mosperputhje relativisht e konsiderueshme dhe jemi të hapur të vëmë në dispozicion formatin dëg të projektit për të mundësuar matjet sipas projektit dhe me pas të verifikohen edhe në veper faktiket.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Ky pretendim merret në konsideratë.

**5. Pretendimi i subjektit:** **Tavan i varur gipsi AMF, ISO 6** Sipas akt-konstatimit të eksperteve të KLSH ka rezultuar të jete një diferencë prej 19.9m<sup>2</sup> nga sipërfaqja librezës së masave 114m<sup>2</sup> më atë të situacionuar 94.2m<sup>2</sup>. Nga parashikimet në projekt, matjet paraprake dhe matjet në veper pas akt-konstatimit rezulton që sipërfaqja e tavanit të varur gipsi AMF, ISO 6 është faktikisht 114 m<sup>2</sup> dhe është bërë lapsus në librezën e masave pasi në të nuk është përfshirë edhe pjesa tjetër që ekziston dhe matur në fakt. Ky tavan është aplikuar tek laboratorit kimik, laboratorit ikonografik dhe dhoma e dezinfektimit të ikonave.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Ky pretendim merret në konsideratë.

**6. Pretendimi i subjektit:** Patinim + lyerje me bojë ALBUS 198 ( Kodi 02B) Sipas akt-konstatimit të eksperteve të KLSH ka rezultuar të jete një diferencë prej 435.08m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e realizuar



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

ne veper 1677.9m<sup>2</sup> me ate te situacionuar 2,113m<sup>2</sup>. Nga projekti, matjet e meparshme dhe matjet faktike ne veper pas akt-konstatimit rezulton qe per kete ze jane realizuar 2,113 m<sup>2</sup> siperfaqe dhe jo 1677.9m<sup>2</sup> siç pretendohet ne Akt Konstatim. Rezulton te jete nje mosperputhje relativisht e konsiderueshme dhe jemi te hapur te veme ne dispozicion formatin dëg te projektit per te mundesuar matjet sipas projektit dhe me pas te verifikohen edhe ne veper faktiket. Emertimet magazine ne librezet e masave dhe siperfaqet perkatese i dedikohen hapesirave funksionale Magazine ne katin 0.00, Punishte e drurit ne katin-1 dhe Dhoma e dizinfektimit ne katin -1 me siperfaqe (5.6m<sup>2</sup>, 5.4m<sup>2</sup>, 4.96m<sup>2</sup>). Megjithate ne total siperfaqja e matshme eshte 2,113m<sup>2</sup> sipas parashikimeve perkatese ne projekt.

**Oëndrimi i Grupit të auditimit:** Ky pretendim nuk merret në konsideratë ,sepse matjet janë kryer sipas planimetrive dhe dimensioneve paraqitura në to.

**7. Pretendimi i subjektit:** Sqarojme me poshte lidhur me te gjitha pajisjet e infrastruktures se brendshme te Muzeut Mesjetar: **Zeri F Pompe drenazhi per riqarkullimin e ujit te basenit ( 2 cope)** Ne momentin e dorezimit te objektit pompat kane gene te vendosura. Me pas jane magazinuar ne object pasi eshte pare si problematike prezenca potenciale e ererave te keqija nga uji perreth Muzeut dhe ndotja potenciale e tyre edhe nga faktori njerezor. Ne foton 4 jane te treguara dy pompat. **Kombinator telefonik VOXOUT** Kjo paisje eshte marre ne dorezim dhe eshte pajisja ne foton 7. **MP3 Player Tuner / CD / MP02** Kjo paisje eshte marre ne dorezim dhe eshte ne fukcion siç shihet dhe ne foto. **Njesi centrali kontrolli.** Kjo paisje eshte montuar dhe eshte ne fukcion sic shihet dhe ne foton me poshte. **Kombinatori Telefonik GSM / GPRS ( 2 cope)** Ne objekt jane instaluar te dy kombinoret telefonike ne momentin e marrjes ne dorezim te tij. Me poshte shohim foto te te dy kombinoreve telefonike qe gjenden ne objekt.

**Oëndrimi i Grupit të auditimit:** Pretendimet në lidhje me këto pajisje merren në konsideratë.

**8. Pretendimi i subjektit:** **1. Ups, 15Kva cos+90, 3ph, 400/400V, 10 min** Ne momentin e dorezimit te objektit pompat kane gene te vendosura. UPS pasi ka funksionuar normalisht per nje periudhe te konsiderueshme kohore eshte hequr nga objekti per arsye te nje avarie ne baterite e tij dhe sistemin e karikimit. Ky defekt ka ndodhur si pasoje e mbingarkeses ne pune dhe si periudhe kohore pas mbarimit te periudhes 2 vjecare te garancise dhe eshte percjelle mirembajtje. Pas riparimit kjo paisje eshte risjelle ne objekt dhe ishte e magazinuar ne dhomen e gjeneratorit, por nuk eshte bere ende riinstalimi i saj. Pajisja tregohet ne foton e meposhtme pasi eshte ngjitur ne dhomen teknike. **2. Softëare dhe programin e sistemit te ndricimit dhe skenareve te kerkuar.** Aktualisht komandimi i ndricimit kryhet ne menyre manuale (pra zgjidhje alternative) nga recepsioni nepermjet panelit te automateve te adresuar sipas skenareve te kerkuar. Tableti konsola e komandimit me softëaren e instaluar e lidhur ne menyre elektronike me panelin e automateve te komandimit, na reklamohet qe eshte demtuar dhe nuk eshte ne gjendje pune aktualisht. Kjo paisje eshte çuar per riparim defekti dhe se shpejti do te risillet ne objekt. Ne foto shihet moduli dhe softi dhe tableti I komandimit. Suport projektori i motorizuar i integruar ne tavan te varur (dhome me sherbime te ndryshme). Modeli SMART – LIFT Projektor me suport automatik per tavan te varur. Paisja eshte demtuar ne 3 vite perdorim, pasi ajo shfrytezohet shpesh per aktivitete edhe jashte objektit (montim/çmontim) dhe nderkohe eshte çuar per riparim. Momentalisht eshte vendosur nje suport i thjeshte i cili kryen funksionin e momentit dhe pritet te rimontohet suporti origjinal.

**Oëndrimi i Grupit të auditimit:** Ndërsa pretendimet në lidhje me UPS, 15kVA cos=90, 3ph, 400/400v, 10 min, Softëare dhe programin i sistemit te ndricimit sipas skenareve te kerkuar,



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

*Suport projektori i motorizuar i integruar në tavan të varur (dhomë me shërbime të ndryshme). Modeli: SMART -LIFT Projektor me suport automatik, për tavan të varur, sepse UPS nuk është funksional siç pranohet dhe në observacion, dhe nuk supozohet që kjo pajisje të punoj vetëm brenda periudhës së garancisë së punimeve, softëare nuk është funksional dhe suporti i projektorit nuk është i motorizuar, por suport i thjeshtë statik.*

**Konkluzion:** Si përfundim sipërmarrësi BOE “K” shpk & "XH" shpk, ka përfituar më tepër për punime të pakryera vlerën **366,667 lekë pa TVSH**, dhe për mos vendosje të pajisjeve në objekt në vlerën **1,462,000 lekë pa tvsh** në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” i ndryshuar dhe Nenin 7 dhe 12 të Ligjit 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** z. E. T., përfaqësues i “DS” SHPK dhe Kolaudatori i punimeve z. P.S.

### **Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

##### **1. Gjetje nga auditimi:**

**a.** Nga NJP, në hartimin e kriterëve për kualifikim, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” nuk është marrë në konsideratë, dokumentacioni i cilësuar në specifikimet teknike, me qëllim përmbushjen e tyre. Konkretisht për materialet e “Veshje fasade” dhe “Profile alumini”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kapitulli III “Dokumentet e tenderti”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”.

**b.** Nga auditimi ka rezultuar se nga NJP, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i infrastrukturës së brendshme të objektit Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës” është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 26 “Kontratat për punë”, pasi nuk është përcaktuar në DT, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesin OE, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim në rastin e automjeteve (leje qarkullimi, akt kolaudimi, certifikata transporti etj), dokumentacioni i cili vërteton gjendjen fizike të mjeteve dhe garancinë për realizimin e kontratës.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2.2, faqet 11-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për përcaktimin e kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur, që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim.

**Menjëherë dhe në vijimësi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga personat përgjegjës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, me





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

ndryshime, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç, pasi **për 18 raste** “zëra punimesh” nuk ka gjurmë, mbi mënyrën e përlllogaritjes së çmimeve të preventivuara. Personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në përcaktimin e çmimeve për njësi sipas zërave të punimeve, nuk i janë referuar as çmimeve sipas “Manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013, si dhe as kanë kryer analizë çmimesh. Në dokumentin “Analiza teknike për punimet në ndërtim” të hartuar nga vetë grupi i punës, rezulton se nuk janë trajtuar këta zëra, si dhe për shkak se mungon procesverbali mbi “Përlllogaritjen e fondit limit” nuk kemi asnjë gjurmë se si është vepruar.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2.3, faqet 11-32 dhe pasqyrën anekse nr.3, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, ku mungojnë analizat, argumentimi si dhe referencat për çmimet e preventivuara, me pasojë rritjen e riskun për shkakimin e efekteve financiare negative, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, Bashkia Korçë, fituar nga BOE “M” SHPK & “EK” SHPK, rezultoi se Projekti i zbatimit, sipas të cilit është zhvilluar ky objekt, rezulton të jetë me mangësi. Projekti i mbrojtjes nga zjarri, i furnizimit me ujë sanitar, i shkarkimit të ujërave të përdorur, i shkarkimit të ujërave atmosferik, projekti elektrik dhe i ndriçimit janë marrë nga projektidea e bërë nga shoqëria “DS” SHPK për objektin “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, faza II-të, i prokuruar për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.1, faqet 32-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Korçë të merren masa që objektet që prokurohen, të jenë të pajisur me projektin e plotë të zbatimit, për të shmangur problemet teknike gjatë zbatimit të punimeve dhe ndryshimet e panevojshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e Kulturës”, Bashkia Korçë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 49,302,685 lekë lekë, fituar nga BOE “M” SHPK & “EK” SHPK, rezultoi se për 4 zëra pune, nuk administrohet librezja e masave. Këto zëra janë:

7.4. Veshje faqet e brendshme të dritareve;

10.3. Zgara metalike me  $d=8\text{mm}/20\text{ cm}$

10.4 FV bordura guri të çukitur  $8 \times 15\text{ cm}$

10.5 Shtresë me pllaka guri të çukitur  $t=4\text{ cm}$ .

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.1, faqet 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit, në mënyrë që të bëhet zbatimi korrekt i projektpreventivit të objektit dhe nga mbikëqyrësi e kolaudatori i punimeve, të verifikohet me përgjegjësi përmbajtja e dosjes teknike, me të gjithë elementët e saj, me qëllim situacionimin e volumeve të punës në mënyrë të argumentuar teknikisht.

**Menjëherë dhe në vijimësi.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar”, u konstatua nuk ndodheshin të vendosur në objekt pajisjet sipas specifikimeve të preventivit dhe një pjesë e tyre nuk janë funksionale.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.2, faqet 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandim:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të kryej verifikimin e të gjitha pajisjeve, ku të kontrollojë nëse janë vendosur sipas specifikimeve teknike dhe nëse janë funksionale.

**Menjëherë**

#### **B.1. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH” dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,828,667 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, sipërmarrësi BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, ka përfituar më tepër duke vendosur pajisje jo sipas specifikimeve teknike dhe jo funksionale në objekt në vlerën **1,462,000 lekë pa TVSH**.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.2, faqet 32-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,462,000 lekë pa TVSH** nga BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të pajisjeve të pa vendosura në objekt sipas preventivit të miratuar nga AK.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, sipërmarrësi BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, ka përfituar më tepër për punime të pakryera vlerën **366,667 lekë pa TVSH**.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.2, faqet 32-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **366,667 lekë pa TVSH** nga BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo në përputhje faktin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK.

**Menjëherë.**

### **B.2. SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT LIGJORE TË PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, konkretisht në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i shfuqizuar dhe VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i shfuqizuar, me pasojë përlllogaritje më tepër e vlerës limit të kontratës në shumën **3,499,806 lekë pa TVSH**.

Nga auditimi ka rezultuar se grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” dhe Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa a “Kontratat për punë”. Referuar të dhënave në disa raste nuk janë vendosur në preventiv çmimet për njësi të përlllogaritura sipas analizës teknike dhe të kostos, si dhe manualeve të çmimeve, konkretisht:

- Për zërin e punimeve “Veshje fasade me pllaka guri” i përcaktuar në preventiv me çmim 8,000 lekë/m<sup>2</sup>, në analizën e kostos është përlllogaritur në vlerën 5,500 lekë/m<sup>2</sup>. Vlera e limit e kontratës për këtë zë punimesh, është përlllogaritur **2,032,500 lekë më shumë**.
- Për zërin e punimeve “Veshje xokoli me pllaka guri”, me çmim 8,000 lekë/njësi, sipas preventivit, nuk është përcaktuar trashësia e gurit (t), as në DT “Specifikimet teknike” dhe as në Preventiv. Gjithashtu, nga personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në dokumentin “Analiza teknike për punimet e ndërtimit me objekt “Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës””, nuk ka analizë kostoje për këtë zë punimesh. Në preventiv çmimi për këtë zë punimesh është përcaktuar 8,000 lekë/m<sup>2</sup>, duke ju referuar çmimit/njësi të zërit të



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

punimeve “Veshje fasade me pllaka guri”, për të cilin në Specifikimet teknike të DT, është ciësuar trashësia e gurit  $t=10$  cm.

Sa më sipër, rezulton se çmimi 8,000 lekë/njësi i vendosur në preventiv, është i paargumentuar si dhe duke ju referuar Manualit nr. 2 të miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kosto për njësi e këtij zëri punimeve “Veshje me pllaka guri” duhej përllogaritur në vlerën 3,399 lekë/m<sup>2</sup>. Për rrjedhojë vlera e fondit limit për këtë zë është përllogaritur **703,953 lekë më shumë**.

- Për zërin e punimeve “Veshje tarrace me pllaka guri”, me çmim 7,800 lekë/njësi, sipas përvendit, nuk është përcaktuar trashësia e gurit (t), as në Specifikimet teknike (Dokumentet e Tenderit) dhe as në Preventiv. Gjithashtu, nga personat përgjegjës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në dokumentin “Analiza teknike për punimet e ndërtimit me objekt “Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës””, nuk ka analizë kostoje për këtë zë punimesh. Në preventiv çmimi për këtë zë punimesh është përcaktuar 7,800 lekë/m<sup>2</sup>.

Sa më sipër, rezulton se çmimi 7,800 lekë/njësi i vendosur në preventiv, është i paargumentuar si dhe duke ju referuar Manualit nr. 2 të miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kosto për njësi e këtij zëri punimeve “Veshje me pllaka guri” duhej përllogaritur në vlerën 3,399 lekë/m<sup>2</sup>. Për rrjedhojë vlera e fondit limit për këtë zë është përllogaritur **673,353 lekë më shumë**.

- Për zërin “Punime të ndryshme”, nën zërin “Urë metalike+druri të lëvizshme” sipas Analizës është përllogaritur çmimi për nën zërin “Mekanizmi lëvizës” sipas Analizës është përllogaritur në shumën 190,000 lekë/copa, ndërsa në Preventiv është shënuar 280,000 lekë/copa. Diferenca për këtë zë punimesh midis Analizës teknike të çmimeve dhe Preventivit është **90,000 lekë më shumë në preventiv**.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2.3, faqet 11-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe eliminimin e shkeljeve, me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e Bashkisë Korçë, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën **3,499,806 lekë pa TVSH**.

**Menjëherë dhe në vijimësi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të zhvilluara, u konstatua se në procedurën e prokurimit “Ndërtim i objektit Qendar për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, kualifikimi dhe shpallja e operatorit ekonomik fitues, është kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pikën 5 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “M” SHPK dhe “EK” SHPK, është shpallur fitues edhe pse ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën **41,096,244 lekë pa TVSH**.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 2.3, faqet 11-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

**2.1. Rekomanim:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomik, të cilët edhe pse nuk kanë plotësuar kriteret e DST janë kualifikuar dhe ahallur fitues, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## C. MASA ADMINISTRATIVE

### **Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Bashkisë Korçë**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Korçë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të cilësuar më poshtë:**

**1. BOE “S” & “I” SHPK**, përfaqësuar nga z.E.T, gjobë në masën 50,000 lekë për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe;

“Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar”, me sipërmarrës punimesh BOE “K” SHPK & “XH” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **366,667 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në punime të likuiduara por të pakryera në fakt dhe vendosjes së pajisjeve jo sipas specifikimeve teknike dhe jo funksionale në objekt në vlerën **1,462,000 pa TVSH**.

*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5.2, faqet 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Menjëherë**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

**V. ANEKSE:**

**Pasqyra nr. 1 “Zërat e punimeve dhe referencat e çmimeve”**

NR.AN	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI- PREVENTIV	ÇMIMI- MANUAL	ÇMIMI- ANALIZE
<b>I</b>	<b>PUNIME NDERTIMORE</b>					
<b>1</b>	<b>PUNIME GERMIMI</b>					
2.25	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m <sup>3</sup> shkarkim toke	m3	560	148	148	
2.1/a	Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria IV	m3	25	855	855	
2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	585	457	457	
2.426/4	Prishje soleta b/a	m3	9	4,353	4,353	
<b>2</b>	<b>PUNIME MURATURE</b>					
2.70/2	Mur me tulla te lehtësuara deri - 3 m, ll perz M 25	m3	162	9,810	9,810	
An	F.V. lesh guri ne murin e godines	m2	625	1,100		1,560
2.68	Mur tulle te plota kollone deri 3m me llaç perzier M 15	m3	2.5	15,736	15,736	
2.86	Mur me tulle per parapet	m3	17	10,006	10,006	
<b>3</b>	<b>PUNIME BETONI DHE BETONARME</b>					
2.118/1	Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 8 m	m3	37.5	15,824	15,824	
2.119/1	Trare b/a C - 16/20, h ~ 4 m	m3	10.5	16,280	16,280	
2.121/1	Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m	m3	5	13,210	13,210	
2.119/1	Arkitrare b.a	m3	3.3	16,280	16,280	
2.126	Soleta b/a me tulla me 6 vrima, Hd = 6m, trashesi 30cm	m2	545	3,089	3,089	
<b>4</b>	<b>PUNIME HEKURI</b>					
2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	20.4	121,677	121,677	
2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	12.3	117,010	117,010	
<b>5</b>	<b>PUNIME HIDROIZOLIMI DHE TARRACE</b>					
An	Hidroizolim i bodrumit me plastivo 200	m2	477	1,909	-	-
An	F.V.Ëaterstop	ml	106	1,509	-	-
An	F.V.Spidy 15 ne kendet e murit te bodrumit	ml	106	1,280	-	-
An	Hidroizolim i tarraces me AQUASCUD 420	m2	497	2,520	-	-
An	Hidroizolim i sip. vertikale me PLASTIVO 200	m2	72	1,680	-	-
An	Termoizolim tarrace me nanoteknologji	m2	497	2,380	-	-
An	Lluster cemento EN 1146 mbi shtresen termoizoluese	m2	569	980	353	627
<b>6</b>	<b>PUNIME PER BASENIN UJOR</b>					



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

An	Mbushje me cakell pas mureve	m3	195	1,015	-	-
An	F V tub drenazhi Ø 150 mm	ml	120	565	-	-
3.184/b	Shtrese zhavor lumi t=40cm	m3	260	506	506	
2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3	33	7,690	7,690	
An.	Hidroizolim me plastivo 200	m2	578	1,680	-	-
An	F.V.Ëaterstop	ml	230	1,509	-	-
2.158	Baseni uJOR b/a C 16/20	m3	38	14,192	14,192	
An	Veshje te basenit uJOR me pllake guri	m2	600	5,600	-	-
<b>7</b>	<b>PUNIME VESHJE FASADE</b>					
An.	Veshje fasade me pllaka guri	m2	813	8,000		5,500
	Veshje me gure (dav. Para elem.dru)					
An.	Veshje tarrace(brenda dhe jashte) me pllaka guri	m2	153	7,800	-	-
An.	Veshje xokoli me pllaka guri	m2	153	8,000	-	-
An.	Veshje faqet e brendshme dritareve me gur	m2	104	12,000	-	-
An.	Davanciale ne tarrace me gur	m2	62	3,399	3,399	
An.	Veshje fasade me drur masiv+detaje hekuri punuar	m2	158	13,500		15,500
<b>8</b>	<b>PUNIME DYER -DRITARE</b>					
2.373	Ndertim kupole me xhami termik opak	m2	35	42,000		42,000
2.373/1	F V vetrare d/alumini plastike me dopio xham	m2	8	12,085	12,085	
2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	45	14,392	14,392	
2.386/2	Dyer te blinduara e veshur me dru	m2	4.5	42,920	42,920	
<b>9</b>	<b>PUNIME TE NDYSHME</b>					
An.	Ure metalike+druri, e levizshme	m2	30	16,500		17,500
An.	Mekanizmi levizes	cope	1	280,000		190,000
<b>10</b>	<b>PUNIME NE AMBJENTIN JAShte GODINES</b>					
	<b>Pjesa me pllaka</b>					
3.211	Shtrese cakelli me mina t=20cm	m2	560	535	535	
3.212c	Shtrese stabilizanti t=15cm dhe cilindrim mbi shtresen e cakellit	m2	560	479	479	
2.262/4	Shtrese betoni M.200 t=20cm	m3	112	9,791	9,491	
3.287	Zgara metalike ,me largesi te tyre ,20 cm Ø8mm	kg	2212	117,017	117,017	
3.616	F V bordura guri te cukitur 8x15 cm	ml	470	4,800		4,800
An.	Shtrese me pllaka guri te cukitur t=4cm	m2	1220	3,399	3,399	



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

<b>11</b>	<b>PJESA ME GJELBERIM</b>					
3.6	Prerje e sistemim pemesh $\varnothing > 76$ cm	cope	3	1,204	1,204	
3.2	Prerje bime te vogla $\varnothing$ -10cm	m2	20	13	13	
3/an	Fidane peme acacia dealbata	cope	8	10,690	10,690	
An	Dhe humusor per mbushje	m2	1100	800	-	-
<b>II</b>	<b>PUNIME MEKANIKE</b>					
<b>1</b>	<b>SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI</b>					
	<b>Kartela sinjalizimi</b>					
An	F.V Lidhja me motopompen (AL-5121-B)	cope	1	840		840
	Sistemi hidraulik i jashtem deri tek ambienti teknik					
2.492	F.V Tubo Zingato + rakorderi $\varnothing$ 2" ,	kg	240	258	258	
An	F.V Elemente konstruksioni ( upa, fasheta, prizhioner, fije lini, paste, etj )	komp	1	7,800	-	-
<b>2</b>	<b>SISTEMI I UJIT TE NGROHTE SANITAR</b>					
	<b>Furnizimi me uje nga rrjeti</b>					
2.15	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave	m <sup>3</sup>	16	602	602	
2.261	F.V Shtrese rere	m <sup>3</sup>	4	1,376		1,347
An	Pusete betoni per lidhjen e ujit dhe furnizim, kontroll, dimensionet $\varnothing$ 90 x h 200mm	cope	1	20,000		20,000
An	F.V Tubo PE - HD $\varnothing$ 75x6.8 mm, PN10 + rakorderi	ml	160	350		350
<b>3</b>	<b>SISTEMI I SHKARKIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA DHE TE SHIUT</b>					
	<b>Kalimet horizontale te shkarkimit te kolonave</b>					
An	F.V Tubo shkarkimi PP $\varnothing$ 125 mm	ml	30	950		950
An	F.V Tapa pastrimi $\varnothing$ 125 mm	cope	1	1,200		1,200
	F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)	komp	1	11,000	-	-
	<b>Shkarkimi i jashtem i ujrave te zeza</b>					
2.1	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave	m <sup>3</sup>	80	602	602	
2.261	F.V Shtrese rere	m <sup>3</sup>	25	1,376	1,376	





**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

An	F.V Puseta betoni (60 x 60 ) cm, me kapak gize D 400 Ø 60 cm	cope	4	28,000		28,000
An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur Ø 200 mm	ml	40	750		750
An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur Ø 300 mm	ml	60	1,600		1,600
An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur Ø 315 mm	ml	20	2,008		2,008
An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur Ø 500 mm	ml	35	5,250		5,250
	<b>Shkarkimi i ujrave te shiut</b>					
	<b>Kollonat e shkarkimit te shiut</b>					
An	F.V Tubo PP shkarkimi Ø 110 mm	ml	60	575		575
An	F.V Tapa pastrimi Ø 110 mm	cope	4	1,060		1,060
An	F.V Tubo PE - HD Ø 110x6.8 mm, PN10 + rakorderi	ml	60	2,830		2,830
An	F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj per tubo PP.)	kompl	1	9,500	-	-
An	F.V Skimer plastik PE - HD DN 110mm per shkarkimin e basenit uJOR	cope	4	12,670		12,670
An	F.V Pike shkarkimi per basenin uJOR, me tape	cope	1	8,500		8,500
	<b>Sistemi i drenazhimit &amp; Pusetat e rrjetit te jashtem te shiut</b>					
2.1	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave	m <sup>3</sup>	30	602	602	
2.261	F.V Shtrese rere	m <sup>3</sup>	10	1,376	1,376	
An	F.V Puseta betoni (60 x 60 ) cm, me kapak gize D 400 Ø 60 cm	m <sup>3</sup>	5	20,000		20,000
	<b>FURNIZIM PAISJE</b>					
<b>4</b>	<b>MAKINERI DHE PAJISJE MEKANIKE</b>					
	Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri					
	Makineri e pajisje					



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

An	F. Grupi i lidhjes me motopompen per hidrant DN70. Vendorsja ne kase te jashtme, llamarine çeliku te emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.	cope	1	22,608	22,608
<b>III</b>	<b>PUNIME ELEKTRIKE</b>				
<b>1</b>	<b>IMPJANTI ELEKTRIK I NDRICIMIT</b>				
1	FV. Ndricules Hermetik LED IP68 per Basenin ujour ne perimeter. 12V DC/ 3/6Ë me TR 170-250/12V	cope	22	27,780	27,780
2	FV.Ndricules Hermetik LED IP67 inkaso Volt 220-240V / 50-60Hz /2Ë	cope	12	9,790	9,790
3	FV.Ndricules Hermetik IP67 Prozhektor LED me orientim 180° 230/50Ë/50Hz.	cope	4	8,679	8,679
4	FV.Ndricules linear LED 12V 7.2Ë/m I kompletuar me aksesore instalimi.	ml	16	2,770	2,770
5	FV.Tub fleksibel me dy shtresa PVC Ø50	ml	260	256	256
6	FV.Tub fleksibel PVC Ø40	ml	120	156	156
7	FV.Tub fleksibel PVC Ø25	ml	60	136	136
8	FV.Tub fleksibel PVC Ø20	ml	100	120	120
9	FV.Kabell elektrik FG7OR 3x1.5	ml	270	112	112
10	FV.Kabell elektrik FG7OR 3x2.5	ml	460	161	161
11	FV.Kabell elektrik FG7OR 5x2.5	ml	200	258	258
12	FV.Kuti hermetike C5/7 IP65	cope	28	1,650	1,650
13	FV.Kuti hermetike C4 IP65	cope	24	468	468
14	FV.Kuti derivacion per inkasim ne toke 300x300	cope	8	3,670	3,670
15	Materiale te tjera plotesuese instalatore	cope	1	40,000	40,000



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

<b>2 IMPIANTI ELEKTRIK RRUFEPRITES DHE TOKEZIM</b>						
1	Antene rrufepritese me shtylle e kompletuar me aksesoret dhe me mates statistikor.	cope	1	437,000		437,000
2	Shirit 35x3.5 mm2 I Zinguar me aksesor dhe me elementet instalator I kompletuar.	cope	1	37,838		37,838
3	Shufer Ø10 e zinguar e kompletuar me gjithë elementet instalator	cope	1	36,450		36,450
4	Materiale te tjera plotesuese instalatore	cope	1	40,000		40,000
<b>3 PANELE ELEKTRIKE</b>						
1	Kuadri elektrik kryesor i shperndarjes per ndricimin e jashtem i kompletuar me mbrojtje MTD sipas skemes elektrike dhe me komandim automatik.Fluks + kabell	cope	1	87,900		87,900
2	Materiale te tjera plotesuese instalatore	cope	1	10,000		10,000

**Pasqyra nr. 2 “Çmimet e preventiuara pa analize teknike”**

NR.AN	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI- PREVENTIV	ÇMIMI- MANUAL	ÇMIMI- ANALIZE
<b>5 PUNIME HIDROIZOLIMI DHE TARRACE</b>						
An	Hidroizolim i bodrumit me plastivo 200	m2	477	1,909	-	-
An	F.V.Ëaterstop	ml	106	1,509	-	-
An	F.V.Spidy 15 ne kendet e murit te bodrumit	ml	106	1,280	-	-
An	Hidroizolim i tarraces me AQUASCUD 420	m2	497	2,520	-	-
An	Hidroizolim i sip. vertikale me PLASTIVO 200	m2	72	1,680	-	-
An	Termoizolim tarrace me nanoteknologji	m2	497	2,380	-	-
<b>6 PUNIME PER BASENIN UJOR</b>						
An	Mbushje me cakell pas mureve	m3	195	1,015	-	-
An	F V tub drenazhi Ø 150 mm	ml	120	565	-	-
An.	Hidroizolim me plastivo 200	m2	578	1,680	-	-
An	F.V.Ëaterstop	ml	230	1,509	-	-
An	Veshje te basenit uJOR me pllake guri	m2	600	5,600	-	-
<b>7 PUNIME VESHJE FASADE</b>						
An.	Veshje tarrace(brenda dhe jashte) me pllaka guri	m2	153	7,800	-	-
An.	Veshje xokoli me pllaka guri	m2	153	8,000	-	-
An.	Veshje faqet e brendshme dritareve me gur	m2	104	12,000	-	-
An	Dhe humusor per mbushje	m2	1100	800	-	-
<b>II PUNIME MEKANIKE</b>						
<b>1 SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI</b>						
An	F.V Elemente konstruksioni ( upa, fasheta, prizhioner, fiJe lini, paste, etj )	komp	1	7,800	-	-
<b>3 SISTEMI I SHKARKIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA DHE TE SHIUT</b>						



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë**  
**Korçë.**

	F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)	komp	1	11,000	-	-
An	F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj per tubo PP.)	kompl	1	9,500	-	-

**5.2. Zbatimi i kontratës “Infrastruktura e brendshme e MKAM**

**Pasyra nr. 3**

SHTRESE BETONI NE BODRUM			
Gjatesi	Gjeresi		Siperfaqe
35.15	0.8		
13.65			468.9
7.3	1.8		13.14
3.9	2.7		10.53
7.05	1.9		13.395
<b>Shuma</b>			<b>505.9</b>

**Pasqyra nr.4**

Patinim lyerje me boje albus				
korridori + salle mbledhje				
Gjatesi	Lartesi			Situacion
0.9				19.19
0.2				6.19
4.3				19.76
7.4				19.19
2.375				5.02
1.92				36.01
7.05				1.98
7.05				19.19
6.75				20.05
1				20.05
		Fakt		20.05
38.945	2.6	101.257		14.2
				4.73
<b>Shuma</b>				<b>185.56</b>
<b>Diferenca</b>				<b>84.303</b>

**Pasqyra nr. 5**

Patinim + Lyerje me bojë ALBUS 198 (Kodi 02B)				
	Gjatësi	Gjërësi	Lartësi	Sipërfaqe
<b>Tualet F</b>	1.82		1.79	3.2578
	0.87		1.53	1.3311
	0.85		1.53	1.3005
<b>Tualet PAK</b>	1.2		2.05	2.46
<b>Tualet M</b>	0.85		1.53	1.3005
	0.17		0.74	0.1258
	1.43		1.09	1.5587



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë.

Shuma				11.33
<b>Magazina</b>	5.4		3.21	17.334
	5.4		3.21	17.334
	5.4		3.2	17.28
	1.25		3.2	4
	1.25		3.2	4
Shuma				59.9
<b>Magazina</b>	5.4		3.21	17.334
	5.4		3.21	17.334
	5.4		3.2	17.28
	1.25		3.2	4
	1.25		3.2	4
Shuma				59.9
<b>Holli</b>	4.25		11.81	50.1925
	5.31		5.32	28.2492
	5.95		2.4	14.28
	3.35		2.74	9.179
	2.88		1.35	3.888
Shuma				105.79
<b>Dhoma Bosh</b>	5.17		3	15.51
	3.65		3	10.95
	5.17		3	15.51
	3.65		3	10.95
	5.17		3.65	18.9
	5.17		3	15.51
	3.65		3	10.95
	5.17		3	15.51
Shuma				113.76
				350.7796

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT